

DHOMAT E SPECIALIZUARA
DHE ZYRA E PROKURORIT TË
SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

RAPORT PËR VITIN 2018



DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

DHOMAT E SPECIALIZUARA
DHE ZYRA E PROKURORIT TË
SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

RAPORT PËR VITIN 2018



DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

PËRMBAJTJA

DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS	5
Parathënie	6
Një vështrim i shpejtë mbi DHSK-në	8
DHOMAT	14
1. Krijimi i kornizës procedurale	15
2. Veprimtaritë e Kryetares dhe të gjykatësve	17
3. Marrëdhëniet e jashtme	21
PROGRAMI PËR KOMUNIKIM DHE NDËRGJEGJËSIM	23
ZYRA ADMINISTRATIVE	30
1. Kabineti i Administratores	34
2. Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun	36
3. Zyra e auditimit	37
4. Zyra e Avokatit të Popullit	37
5. Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore	39
5.1 Njësia për Administrimin e Gjykatës	39
5.2 Njësia e Përkthimit	40
5.3 Zyra e Mbrojtjes	40
5.4 Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave	41
5.5 Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve	43
5.6 Njësia e Paraburgimit	43
6. Seksioni i Administratës	44
6.1 Njësia e Burimeve Njerëzore	44
6.2 Njësia e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit	46
6.3 Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme	47
6.4 Njësia e Sigurisë	47
6.5 Njësia e Financave dhe Buxhetit	48
6.6 Njësia e Prokurimit	49
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR	51
Parathënie	52
Zhvillimi i Zyrës së Prokurorit të Specializuar	53

**DHOMAT E
SPECIALIZUARA
TË KOSOVËS**

PARATHËNIE

Është nder për ne që të paraqesim raportin vjetor të vitit 2018 të Dhomave të Specializuara të Kosovës – një institucion i ri i cili ka krijuar një bazë ligjore dhe administrative të qëndrueshme për realizimin e plotë të mandatit të vet për kryerjen e procedurave penale të pavarura, të paanshme, efikase dhe të drejta, në një mjedis të sigurt.

Ndërsa në Raportin tonë të parë kemi theksuar qartë arritjet kryesore për sa i takon ngritjes së këtij institucioni të ri gjyqësor, në këtë raport synojmë të japim një përditësim të hollësishëm të zhvillimeve që kanë ndodhur në Dhomat e Specializuara të Kosovës gjatë vitit 2018.

Të udhëhequr nga angazhimi ynë për të siguruar administrimin efikas të gjykimeve të ardhshme, gjatë vitit 2018 është bërë një përparim i madh në forcimin e mëtejshëm të kornizës normative dhe procedurale të institucionit tonë, duke u mbështetur në mësimet e nxjerra nga institucione të tjera të ngjashme gjyqësore dhe duke punuar në bashkëpunim të ngushtë brenda institucionit, si dhe me palë të jashtme të interesuara.

Hartimi i një kornize ligjore që siguron procese efektive ka qenë një përparësi kyçe e Dhomave të Specializuara të Kosovës në vitin 2018. Ne kemi mbledhur dhe analizuar praktikën më të mira dhe kemi krijuar instrumente novatore për të siguruar kryerjen e proceseve të drejta dhe të sigurta, ku të drejtat e të akuzuarve dhe të viktimave të respektohen plotësisht, duke garantuar në të njëjtën kohë gjykime të shpejta dhe efikase. Gjykatësit – të cilët caktohen në një regjistër dhe i ushtrojnë funksionet e tyre

përkatësisht vetëm sipas nevojës – vijojnë të jenë shumë të angazhuar në këtë proces, duke dhënë kontribute të vyera dhe duke u mbështetur në përvojën e tyre të gjerë si në procese penale në vendet e tyre, po ashtu edhe në procese penale ndërkombëtare. Zyra Administrative po ashtu e ka përqendruar vëmendjen në krijimin e instrumenteve për administrimin e gjykatës që synojnë lehtësimin e pjesëmarrjes së palëve dhe viktimave dhe ofrimin e ndihmës gjykatësve në kryerjen e detyrave të tyre.

Transparenca vazhdon të jetë një gurthemel i rëndësishëm në punën e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe tashmë është ngulitur fort në kulturën e institucionit tonë. Programi gjithëpërfshirës i Dhomave të Specializuara të Kosovës kushtuar komunikimit dhe ndërgjegjësimin luan një rol kyç në realizimin e angazhimit tonë në këtë drejtim. Një nga arritjet kryesore të vitit 2018 ishte vënia në punë e faqes së përditësuar të internetit të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës, e cila përmban arkivin e dokumentacionit gjyqësor, duke siguruar qasjen në dokumentet publike për një publik sa më të gjerë, si edhe transmetimin me zë dhe figurë të përmbajtjes së seancave publike të gjykatës. Gjithashtu, kemi dendësuar përpjekjet tona për informim dhe komunikim të rregullt me komunitetet dhe grupet e shumta në Kosovë dhe në rajonet përreth, përfshirë shoqërinë civile, grupet e pakicave, OJQ-të dhe juristët.

Ne do të vijojmë përpjekjet për të garantuar që mandati dhe roli i Dhomave të Specializuara të Kosovës të kuptohen në kontekstin e duhur nga popullatat përkatëse, si dhe për të ushqyer

dialogun ndërveprues me komunitetet e Kosovës dhe gjetkë, të nisur që me krijimin tonë. Ky Raport ka për qëllim të demonstrojë më tej përkushtimin tonë ndaj transparencës së plotë të punës sonë.

Për arritjet e mësipërme, u jemi shumë mirënjohës Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe shteteve të treta kontribuese për mbështetjen e vazhdueshme të përpjekjeve tona – si financiarisht, po ashtu edhe politikisht. Gjithashtu, dëshirojmë të shprehim vlerësimin tonë për shtetin pritës për lehtësimin e aktiviteteve tona në Holandë.

Në të njëjtën kohë, falënderojmë sinqerisht homologët tanë të Shërbimit të Jashtëm të Bashkimit Evropian, Shërbimit të Komisionit Evropian për Instrumentet e Politikës së Jashtme si dhe të Zyrës së Kapaciteteve për Planifikim dhe Drejtim Civil për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre për çështje të ndryshme të lidhura me institucionin tonë.

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Kryetare e Dhomave të Specializuara të Kosovës

Hagë, shkurt 2019

Gjithashtu, u shprehim mirënjohjen tonë shteteve, anëtarëve të komunitetit diplomatik, si edhe gjykatave dhe tribunalëve ndërkombëtarë dhe të ndërkombëtarizuar në Hagë, për bashkëpunimin dhe shkëmbimet e rregullta konstruktive me ne për çështje organizative dhe administrative.

Të pajisur me instrumentet më të mira dhe në përputhje me mandatin e tyre, Dhomat e Specializuara të Kosovës janë të vendosura të vazhdojnë të ndërtojnë më tej mbi kornizën solide ligjore dhe administrative, me ambicien për t'u bërë një institucion gjyqësor që jep shembullin e efikasitetit dhe transparencës, duke siguruar ndërkohë respektimin e plotë të të drejtave të të dyshuarve dhe të akuzuarve për gjykim të drejtë, si edhe garantimin e sigurisë së dëshmitarëve dhe viktimave. Gjatë gjithë këtij procesi, ne do të ruajmë dhe theksojmë në çdo kohë rëndësinë e jashtëzakonshme të pavarësisë sonë si institucion gjyqësor, jashtë çdo ndikimi apo ndërhyrjeje politike.

Dr. Fidelma Donlon

Administratore e Dhomave të Specializuara të Kosovës

NJË VËSHTRIM I SHPEJTË MBI DHSK-NË

Në **qershor 2008**, Komisioni i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut emëroi një raportues të posaçëm për hetimin e pretendimeve për krime të rënda të kryera nga pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) gjatë dhe pas konfliktit të viteve 1998-1999.

Në **janar të 2011**, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi, me Rezolutën 1782 (2011), raportin e përgatitur nga raportuesi i posaçëm (Raporti i Këshillit të Evropës) në të cilin pretendohet se ishin kryer krime të shumta kundër serbëve, shqiptarëve të Kosovës të dyshuar si bashkëpunëtorë dhe kundër individëve të tjerë.

Në vijim të Raportit të Këshillit të Evropës në **maj 2011**, shtetet anëtare të BE-së e shqyrtuan çështjen në kuadër të Komisionit Politik dhe të Sigurisë – organi që merret me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së. Pas kësaj, u themelua Task Forca Hetimore Speciale (TFHS), e cila u ngarkua me detyrën e kryerjes së hetimeve të pavarura të pretendimeve për ndalim të paligjshëm, dëbim, veprime çnjerëzore, tortura dhe vrasje, si dhe për çdo vepër penale tjetër të lidhur me Raportin e Këshillit të Evropës. Me seli në Bruksel, TFHS-ja filloi punën në **shtator 2011**.

Ndërkohë që vazhdonin hetimet, përmes një Shkëmbimi letrash midis Presidentes së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë, në **prill 2014**, u arrit një marrëveshje ndërkombëtare për themelimin dhe funksionimin e dhomave të veçanta gjyqësore për ndjekjen penale të krimeve që mund të rezultojnë nga hetimet e TFHS-së.

Shkëmbimi i letrave parashikonte që këto dhoma gjyqësore të krijoheshin brenda sistemit gjyqësor të Kosovës, por do të kishin statutin dhe rregulloren e tyre të procedurës dhe të provave, si dhe do të përbëheshin vetëm nga punonjës dhe drejtues ndërkombëtarë. Në shkëmbimin e letrave thuhej gjithashtu se dhomat e posaçme gjyqësore do ta kishin selinë në një shtet të tretë dhe se procedurat e ndjeshme, ndër të cilat dëgjimi i dëshmitarëve, do të kryheshin jashtë Kosovës. Shkëmbimi i letrave u ratifikua nga Kuvendi i Kosovës me dy të tretat e votave në prill 2014 dhe u bë pjesë e legjislacionit të vendit.

Në **korrik 2014**, Kryeprokurori i TFHS-së bëri një deklaratë sipas të cilës "TFHS-ja është në gjendje të ngrejë aktakuzë ndaj disa zyrtarëve të lartë të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës".

Në **mars 2015**, Kryetari i Kuvendit të Kosovës i referoi Gjykatës Kushtetuese të Kosovës një amendament kushtetues të propozuar nga qeveria e Kosovës për vënien në zbatim të shkëmbimit të letrave. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese e Kosovës duhej të vlerësonte nëse amendamenti i propozuar cenonte ndonjë prej të drejtave dhe lirive të garantuara nga Kapitulli II i Kushtetutës. Në **prill 2015**, Gjykata Kushtetuese e Kosovës u shpreh se amendamenti i propozuar ishte në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe se "struktura, fushëveprimi i juridiksionit dhe funksionimi i Dhomave të Specializuara do të rregullohet me ligje të tjera, në përputhje me Kushtetutën".

Ky amendament hyri në fuqi me nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës, miratuar nga Kuvendi i Kosovës në **gusht 2015**. Në të njëjtën kohë u

miratua edhe **Ligji** për themelimin e dy institucioneve - instrumenti themelues i Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS).

Në **prill 2016**, dr. Fidelma Donlon u emërua Administratore e Dhomave të Specializuara, çka shënon fillimin e punës së Zyrës Administrative të DHSK-së në Hagë.

Në **shtator 2016**, David Shvendiman (Schwendiman) u emërua Prokuror i Specializuar.

Në **dhjetor 2016**, gjykatësja Ekaterina Trendafilova u emërua Kryetare e DHSK-së dhe filloi punë në atë post në janar 2017.

Më **1 janar 2017**, hyri në fuqi Marrëveshja me Shtetin Pritës midis Kosovës dhe Holandës, sipas të cilës DHSK-ja mund të zhvillonte procedura penale në territorin e Holandës. Pas kësaj, në **shkurt 2017**, u emëruan nëntëmbëdhjetë gjykatës në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara. Në **mars 2017**, në Plenaren e parë, gjykatësit e Dhomave të Specializuara miratuan Rregulloren e Procedurës dhe të Provave.

Me hyrjen në fuqi të Rregullores së Procedurës dhe të Provave në **korrik 2017**, pas një shqyrtimi të kushtetutshmërisë së saj nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, Dhomat e Specializuara u bënë plotësisht funksionale në aspektin gjyqësor.

Në **nëntor 2017**, Administratorja miratoi Direktivën për Mbrojtësit e cila, ndër të tjera, rregullon kriteret për përzgjedhjen e mbrojtësve për përfaqësimin e të dyshuarve, të akuzuarve dhe viktimave para DHSK-së. Që atëherë, në Listën e Mbrojtësve të Specializuar dhe Mbrojtësve të Viktimave janë pranuar 118 avokatë nga Kosova, Serbia, dhe një numër vendesh të tjera.

Në **mars 2018**, gjykatësit e DHSK-së u mbledhën në Plenaren e tretë.

Në **maj 2018**, Pietro Spera u emërua Avokat i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Në **qershor 2018**, u ngrit Rrjeti për Informim i Gjykatës, që përfshin OJQ vendore nga Kosova dhe Serbia.

Në **shtator 2018**, pas David Shvendimanit, në postin e Prokurorit të Specializuar u emërua Xhek Smith (Jack Smith).

**JANAR 2011**

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (KiE) miraton një Raport mbi "Trajtimin çnjerëzor të personave dhe trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë".

2011

2012

2013

2014

2015

2016

**SHTATOR 2011**

Fillon punën Task Forca Hetimore Speciale (TFHS), e ngritur nga BE-ja për të kryer hetime penale të akuzave në Raportin e KiE-së.

PRILL 2014

Presidentja e Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë shkëmbejnë letra në lidhje me "krijimin e "dhomave të veçanta gjyqësore".

SHTATOR 2016

David Shvendiman emërohet Prokuror i Specializuar.

**DHJETOR 2016**

Gjykatësja Ekaterina Trendafilova emërohet Kryetare e DHSK-së.

GUSHT 2015

Kuvendi i Kosovës miraton nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

**PRILL 2016**

Dr. Fidelma Donlon emërohet Administratore e DHSK-së, çka shënon fillimin e punës së institucionit gjyqësor në Hagë.

MARS 2017

Gjykatësit miratojnë Rregulloren e Procedurës dhe të Provave, e cila do të shqyrtohet nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese.

JANAR 2017

Hyn në fuqi Marrëveshja me Shtetin Pritës midis Kosovës dhe Holandës, që i mundëson DHSK-së zhvillimin e procedurave penale në Holandë.

KORRIK 2017

Hyn në fuqi Rregullorja e Procedurës dhe e Provave, pas shqyrtimit të kushtetutshmërisë së saj nga ana e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese dhe Dhomat e Specializuara të Kosovës bëhen funksionale në aspektin gjyqësor.

**SHTATOR 2018**

Xhek Smith emërohet në postin e Prokurorit të Specializuar pas David Shvendimanit.

2017

2018

**SHKURT 2017**

Emërohen 19 gjykatës në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë.

NËNTOR 2017


Administratorja miraton Direktivën për Mbrojtësit, që rregullon çështje të tilla si kriteret e pranimi të mbrojtësve për të përfaqësuar të dyshuarit, të akuzuarit dhe viktimat para DHSK-së. Në fund të vitit 2018, në Listat e Mbrojtësve të Specializuar dhe Mbrojtësve të Viktimave ishin pranuar 118 avokatë.

**MAJ 2018**

Pietro Spera emërohet Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar janë dy institucione të pavarura, të ngritura në bazë të një amendamenti kushtetues dhe Ligjit

për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, miratuar nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2015.



■ **Mandati** i Dhomave të Specializuara të Kosovës është:

“të garantojnë procedura penale të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase në lidhje me pretendimet për krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë konfliktit në Kosovë dhe pas tij, të cilat ndërlidhen me ato që janë raportuar në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës [...] dhe të cilat kanë qenë objekt i hetimeve penale nga ana e Task Forcës Hetimore Speciale” (Neni 1 i Ligjit)

■ DHSK-ja është një institucion gjyqësor i përkohshëm

- ajo do të ekzistojë vetëm për aq kohë sa do të jetë e nevojshme për gjykimin e akuzave të paraqitura nga Prokurori i Specializuar dhe deri sa Këshilli i BE-së ta njoftojë Kosovën për përfundimin e hetimeve dhe procedurave.

■ DHSK-ja është pjesë e **sistemit gjyqësor të Kosovës**, dhe

- përbëhet nga të njëjtat shkallë gjyqësore si sistemi gjyqësor i Kosovës (themelore, e apelit, supreme, kushtetuese);
- ka një seli jashtë Kosovës;
- përbëhet nga gjykatës dhe punonjës që janë qytetarë të shteteve anëtare të BE-së ose të shteteve të treta kontribuese;
- zbaton të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe të drejtën penale materiale të Kosovës, sikundër parashikohet në Ligj;
- zbaton Rregulloren e vet të Procedurës dhe të Provave.

■ **Juridiksioni** i DHSK-së përfshin:

- krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe krimet e tjera sipas të drejtës penale të zbatueshme në kohën kur janë kryer këto krime:
 - që kanë ndodhur nga 1 janari i vitit 1998 deri më 31 dhjetor të vitit 2000;
 - që kanë nisur të kryhen ose janë kryer në Kosovë, apo janë kryer nga persona apo ndaj personave me shtetësi të Kosovës/Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ);
- krimet e caktuara kundër administrimit të drejtësisë, kur kanë lidhje me procedurat zyrtare dhe/ose me zyrtarët e saj.

■ DHSK-ja merret **vetëm me përgjegjësi penale individuale** – ajo nuk do të gjykojë grupe ose organizata.

■ DHSK-ja lejon **pjesëmarrjen e viktimave** në procedura.

■ DHSK-ja dhe ZPS-ja financohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe nga shtetet e treta kontribuese dhe janë të pavarura në përmbushjen e mandatit dhe kryerjes së punës së tyre.



DHOMAT

1. Krijimi i kornizës procedurale

Dhomat e Specializuara të Kosovës u bënë funksionale në aspektin gjyqësor në korrik të vitit 2017, me hyrjen në fuqi të Rregullores së Procedurës dhe të Provave. Që atëherë, DHSK-ja është e gatshme të pranojë çdo parashtrim për protokollim, aktakuzë apo parashtrim tjetër ligjor, me qëllim fillimin e procedurave gjyqësore. Vendimi për nisjen e procedurave gjyqësore i takon vetëm Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS), që është plotësisht e pavarur nga DHSK-ja.

Që nga mesi i vitit 2017, Dhomat e Specializuara janë gati për fillimin e procedurave gjyqësore kurdo që Prokurori i Specializuar të paraqesë akuzat. Ne po e përdorim këtë kohë në mënyrë efikase dhe të matur për të siguruar që gjykimet e ardhshme të zhvillohen shpejt dhe që të gjithë dëshmitarët e mundshëm të jenë të sigurt.

*Kryetarja Trendafilova,
Op-Ed, Kosova Sot/Ekspres, dhjetor 2018*

Me synimin e përbushjes së mandatit të vet për garantimin e procedurave të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase, DHSK-ja ka vijuar të përqendrohet në hartimin e një kornize solide procedurale dhe ka krijuar instrumente ligjore që rregullojnë aspektet teknike të procedurave dhe funksionimin e brendshëm të DHSK-së.

Pas miratimit të dokumenteve themelore, si Rregullorja e Procedurës dhe e Provave, Rregullorja për Emërimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë, Kodi i Etikës Gjyqësore për gjykatësit e emëruar në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të

Kosovës, Procedura për Ankesat e Punonjësve dhe Direktiva për Mbrojtësit në 2017, gjatë vitit 2018, Dhomat kanë punuar me një numër dokumentesh të tjera të rëndësishme normative.

Për shembull, gjykatësit janë konsultuar lidhur me **Kodin e Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës**, një dokument që do të aprovohet nga Administratorja pas miratimit nga Kryetarja. Qëllimi i këtij dokumenti është rregullimi i standardeve profesionale të zbatueshme për mbrojtësit që ushtrojnë profesionin para DHSK-së dhe krijimi i një mekanizmi disiplinor në rast shkeljeje të tij. Ai do të mbulojë jo vetëm sjelljen e mbrojtësve të të dyshuarve, të akuzuarve dhe të viktimave, por edhe sjelljen e prokurorëve. Në përpjekje për të hartuar rregullore që përbushin pritshmëritë e palëve të ndryshme të interesuara, Kryetarja e DHSK-së, gjykatëse Ekaterina Trendafilova, ka marrë gjithashtu mendimet e një morie aktorësh mbi këtë dokument, përfshirë ZPS-në, dhe përfaqësues të mbrojtësve në Listën e Mbrojtësve të Specializuar dhe në Listën e Mbrojtësve të Viktimave.

Gjithashtu, në korrik 2018, Kryetarja Trendafilova miratoi **Udhëzuesin e Punës të Komisionit për Rregulloren, në bazë të rregullës 7 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave**, për ngritjen e Komisionit që ngarkohet me shqyrtimin e propozimeve për ndryshime të Rregullores së Procedurës dhe të Provave.

Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të saj për administrimin gjyqësor të DHSK-së, Kryetarja Trendafilova është përfshirë gjerësisht, së bashku me Administratoren, në hartimin e Rregullores së Ndhmës Juridike, dhe ka

Udhëzuesi i Punës i Komisionit për Rregulloren i formuar në bazë të rregullës 7 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave
Data e miratimit dhe hyrjes në fuqi: 10 korrik 2018

Çfarë rregullon: krijimin e Komisionit për Rregulloren, parashikuar në rregullën 7 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (Rregullorja) dhe procedurën e paraqitjes dhe shqyrtimit të çdo propozimi për ndryshime në Rregullore nga gjykatësit, Prokurori i Specializuar, Organi Përfaqësues i Pavarur i Mbrojtësve të Specializuar, apo nga Administratorja.

Arsyetimi: Miratimi i Udhëzuesit të Punës së Komisionit për Rregulloren synon garantimin e procedurave transparente dhe efikase para Komisionit për Rregulloren.

Përmbajtja: Udhëzuesi i Punës i Komisionit për Rregulloren parashikon se Kryetarja cakton dy gjykatës që do të bëjnë pjesë së bashku me të në Komisionin për Rregulloren

për një vit. Me të kërkohet që çdo propozim për ndryshim të përfshijë: (a) tekstin e ri të propozuar të rregullës përkatëse (b) arsyet për propozimin; (c) pajtueshmërinë e tekstit të ri me Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjin për Dhomat dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar; dhe (d) ndikimin e tij të mundshëm në rregullat e tjera apo në çdo dispozitë tjetër përkatëse që rregullon procedurat para DHSK-së. Gjithashtu ai rregullon procedurën për shqyrtimin e propozimeve nga Komisioni për Rregulloren dhe mekanizmin e raportimit në Plenaren e Gjykatësve.

Ku gjendet: Udhëzuesi i Punës i Komisionit për Rregulloren është publik dhe mund ta gjeni në faqen e internetit të DHSK-së.

bërë komente për dokumente të ndryshme normative që rregullojnë parburgimin nën autoritetin e DHSK-së, që do të miratohen nga Administratorja në 2019. **Rregullorja e Ndhmës Juridike** do të rregullojë regjimin e zbatueshëm për shpërblimin e mbrojtësve të caktuar për të dyshuarit, të akuzuarit, viktimat apo çdo person tjetër të varfër, që ka të drejtën e përfaqësimit ligjor. Në veçanti, këto rregulla do të përcaktojnë procedurën për të vlerësuar nëse një person ka mjete të mjaftueshme financiare për të paguar përfaqësimin e vet juridik, si edhe skemën e përlogaritjes së shumës së ndihmës juridike që do t'i jepet. **Rregullorja e Parburgimit** dhe dokumentet e tjera që kanë të bëjnë me parburgimin – si Udhëzuesi i Punës për Ankesat, Udhëzuesi

i Punës për Disiplinën dhe Udhëzuesi i Punës për Vizitat dhe Komunikimet – parashikojnë, ndër të tjera, mekanizmat e ankesave dhe mekanizmat disiplinorë për të parburgosurit, si dhe rregullojnë procedurat e vizitave të mbrojtësve dhe të afërmeve.

Për të plotësuar kornizën ligjore të DHSK-së në lidhje me parburgimin, Kryetarja dhe Administratorja kanë negociuar një **Marrëveshje midis Dhomave të Specializuara dhe KNKK-së mbi Vizitat te Personat që u është hequr Liria, në përputhje me juridiksionin e Dhomave të Specializuara**, e cila përcakton procedurën e vizitave të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq te personat e privuar nga liria në përputhje me juridiksionin e DHSK-së.

2. Veprimtaritë e Kryetares dhe të gjykatësve

Gjykatësit e DHSK-së emërohen në një Regjistër të Gjykatësve dhe i ushtrojnë funksionet gjyqësore të tyre, sipas nevojës, me kërkesën e Kryetares. Në përputhje me nenin 26 të Ligjit për Dhomat e Specializuara

dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji), gjykatësit nuk marrin pagesë apo përfitime të tjera për faktin që janë në Regjistër dhe i ushtrojnë funksionet e tyre nga larg, për aq sa është e mundur.



Gjykatësit e DHSK-së

Për shkak të përgjegjësive për administrimin gjyqësor të DHSK-së dhe për kryerjen e një numri funksionesh të tjera kyçe që i ngarkohen Kryetarit në bazë të Ligjit dhe Rregullores së Procedurës dhe të Provave, Kryetarja Trendafilova është e pranishme në selinë e DHSK-së dhe shërben me orar të plotë pune.

Në vitin 2018, Kryetarja dhe gjykatësit u angazhuan në punën për miratimin e dokumenteve të ndryshme ligjore, diskutuan zhvillimet në DHSK me synimin për t'u përgatitur për veprimtari të tjera të ardhshme gjyqësore, si dhe shkëmbyen mendime për praktikat më të mira dhe politikat e brendshme.

Gjykatësit e Regjistrit të Gjykatësve Ndërkombëtarë



gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare (Bullgari)



gjykatës Keith Raynor
nënkryetar
(Mbretëria e Bashkuar)



gjykatës Vidar Stensland
gjykatës kushtetues
(Norvegji)



gjykatës Roland Dekkers
gjykatës kushtetues
(Holandë)



gjykatëse Ann Power-Forde
gjykatëse kushtetuese
(Irlandë)



gjykatës Antonio Balsamo
gjykatës kushtetues
rezervë (Itali)



gjykatës Charles L. Smith, III
(SHBA)



gjykatëse Christine van den Wyngaert
(Belgjikë)



gjykatëse Michèle Picard
(Francë)



gjykatës Thomas Laker
(Gjermani)



gjykatës Emilio Gatti
(Itali)



gjykatës Michael Bohlander
(Gjermani)



gjykatës Kai Ambos
(Gjermani)



gjykatës Kenneth Roberts
(Kanada)



gjykatëse Mappie Veldt-Foglia
(Holandë)



gjykatës Christoph Barthe
(Gjermani)



gjykatës Vladimir Mikula
(Republika Çeke)



gjykatës Guénaél Mettraux
(Zvicër)



gjykatës Nicolas Guillou
(Francë)



gjykatës Andres Parmas
(Estoni)

Vëmendje e posaçme iu kushtua sidomos hartimit të politikave dhe praktikave që do të mundësojnë kryerjen e drejtë, efektive dhe të shpejtë të punës gjyqësore.

Në përputhje me Rregullën 10 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, e cila parashikon që Plenaret të mbahen të paktën një herë në çdo vit kalendarik, gjykatësit u mbledhën në **Plenare** në mjediset e DHSK-së në Holandë në mars të 2018. Plenarja u përqendrua në aktivitetet e Zyrës Administrative në pritje të procedurave të ardhshme gjyqësore.

Në qershor 2018, me ftesën e Shkollës Kombëtare Franceze për Gjyqësorin, gjykatësit u mbledhën në Paris, Francë, për një **seminar** dyditor kushtuar çështjeve tematike që lidhen me procedurat e ardhshme gjyqësore dhe diskutuan mësimet e nxjerra nga institucionet e tjera.

Seminari u organizua në frymën e praktikës së nisur në shtator 2017 në Nuremberg, Gjermani, ku gjykatësit u mbledhën për një seminar të organizuar nga Akademia Ndërkombëtare e Parimeve të Nurembergut.

Me synim përgatitjen e mëtejshme të gjykatësve për kryerjen e detyrave të tyre në procedurat e ardhshme gjyqësore, gjykatësit e Dhomave të Specializuara përgatitën dy dokumente paraprake (projekt-dokumente për diskutim): dokumentin për diskutim mbi **Administrimin Efikas të Procedurave**, i cili shqyrton praktikat më të mira për garantimin e procedurave të drejta dhe efektive brenda

kornizës ligjore të DHSK-së dhe analizon instrumentet për vendosjen e një kulture të përbashkët efikasiteti, dhe dokumentin për diskutim mbi **Jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me Shkelje të të Drejtave të Njeriut në Procedurat Penale dhe Çështje lidhur me Pranimin e Referimeve**.

Në vijim të seminarit të Parisit dhe të projekt-dokumenteve për diskutim dhe me mbështetjen e rëndësishme të Institutit Kombëtar Bullgar të Drejtësisë, gjykatësit organizuan një **Takim Pune për Administrimin Efikas të Procedurave** në Varna, Bullgari, në shtator të 2018. Takimi i punës u dha mundësi gjykatësve të diskutonin gjerësisht çështjet e ngritura në dokumentet për diskutim mbi Administrimin Efikas të Procedurave – përfshirë rolin dhe përgjegjësinë e tyre në kryerjen e procedurave efikase brenda kornizës ligjore të DHSK-së – dhe praktikat më të mira gjyqësore, dhe të shkëmbejnë përvojat e tyre të administrimit efikas të çështjeve që mund të dalin gjatë fazave të ndryshme të procedurave. Gjykatësit identifikuan gjithashtu edhe sfida të tjera të mundshme që duheshin trajtuar gjatë vitit 2019.

Në frymën e vendosjes së një baze për zhvillimin efikas të procedurave, Njësia e Mbështetjes Juridike të Dhomave (NJMJDH) ka punuar në disa projekte të brendshme kërkimore që synojnë të lehtësojnë zgjidhjen nga gjykatësit të çështjeve që mund të dalin në të ardhmen.



Seminari në Paris, Francë - qershor 2018

Gjatë gjithë vitit 2018, Kryetarja gjithashtu ka vazhduar të mbështesë dialogun dhe bashkëpunimin ndërmjet dy organeve të DHSK-së, si edhe midis DHSK-së dhe ZPS-së, duke u takuar rregullisht me Administratoren dhe Prokurorin

e Specializuar dhe duke u angazhuar në shkëmbime konstruktive mendimesh për dokumente të ndryshme, të cilat tani përbëjnë kornizën ligjore të DHSK-së.



Gjykatësit e DHSK-së, takim pune mbi administrimin e efikas të procedurave, Varna, Bullgari - shtator 2018

3. Marrëdhëniet e jashtme

Gjatë periudhës së raportimit, Kryetarja Trendafilova ka punuar për promovimin e mandatit dhe funksionimin efikas të DHSK-së. Për të siguruar zgjidhjen e shpejtë dhe efikase për çdo çështje që prek DHSK-në dhe për t'i mbajtur palët e interesuara të informuara në lidhje me zhvillime të rëndësishme, Kryetarja është takuar rregullisht në Hagë dhe në Bruksel me përfaqësues të institucioneve të BE-së, të shteteve anëtare, të shtetit pritës dhe të shteteve të treta kontribuese. Si pjesë e përpjekjeve të DHSK-së në këtë drejtim, në dhjetor 2018 u organizua një takim informues diplomatik gjatë të cilit të tre drejtuesit informuan për zhvillimet më të fundit dhe iu përgjigjën pyetjeve.

Për të forcuar më tej marrëdhëniet e DHSK-së me aktorë të tjerë të jashtëm dhe me shoqërinë civile, Kryetarja Trendafilova zhvilloi takime me anëtarë të komuniteteve të diplomatëve, juristëve, politikanëve, gazetarëve dhe akademikëve në Hagë, Bruksel dhe gjetkë. Në këtë kuadër, në sesionin e Institutit Brandeis për gjykatës ndërkombëtarë mbajtur në Oslo, Norvegji, në korrik 2018, Kryetarja ritheksoi përsëri angazhimin e DHSK-së ndaj efikasitetit. Po ashtu, në dhjetor 2018, Kryetarja mbajti një fjalim në një aktivitet kushtuar "Deklaratës së Parisit për Efikasitetin e Gjykatave Penale Ndërkombëtare" në kuadër të veprimtarive paralele të Asamblesë së Shteteve Palë të Gjykatës Penale Ndërkombëtare të vitit 2018, që u zhvillua në Hagë. E nxitur nga



Kryetarja Ekaterina Trendafilova, Administratorja Fidelma Donlon dhe Prokurori i Specializuar Xhek Smith, Informim diplomatik - dhjetor 2018

vendosmëria për të garantuar transparencën dhe në kuadër të kompetencave të saj, Kryetarja do të vijojë të komunikojë në lidhje me punën e DHSK-së me një audiencë sa më të gjerë që të jetë e mundur.

Përmes përfshirjes aktive në botimin e Raportit të Parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe kontributit të tyre për vënien në funksionim të faqes së re të internetit, Dhomat i kanë dhënë një nxitje të mëtejshme realizimit të aspiratës për ta sjellë DHSK-në sa më pranë popullatave përkatëse.

Gjithashtu, Njësia e Mbështetjes Juridike të Dhomave (NJMJDH) ka kontribuar për nxitjen dhe zgjerimin e dialogut të DHSK-së me komunitetet brenda Kosovës dhe gjetkë, duke marrë pjesë në diskutime në panele, tryeza të rrumbullakëta dhe takime pune me të rinj e të reja, si dhe duke mbajtur prezantime në seminarin për gazetarët e Kosovës që u zhvillua në nëntor 2018. NJMJDH-ja gjithashtu është përfshirë në Programin e Vizitorëve të DHSK-së për studentët dhe juristët.

PROGRAMI PËR KOMUNIKIM DHE NDËRGJEGJËSIM

Programi për Komunikim dhe Ndërgjegjësim i DHSK-së synon të kultivojë njohuri dhe të ndërgjegjësojë njerëzit në lidhje me mandatin dhe mënyrën e punës së DHSK-së, t'i bëjë procedurat gjyqësore më të qasshme dhe më të kuptueshme, si dhe të nxisë pritshmëri reale në lidhje me punën e DHSK-së. Duke iu përgjigjur shqetësimeve të komuniteteve të prekura dhe duke iu kundërvënë perceptimeve të gabuara, Programi për Komunikim dhe Ndërgjegjësim nxit pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile në procedurat e DHSK-së.

Me anë të konsultimeve të shpeshta me organizatat partnere, seancave informuese me gazetarë, ligjëratave dhe programit për vizitorët, takimeve me pjesëmarrje të gjerë të qytetarëve dhe diskutimeve në tryeza të rrumbullakëta,

Programi për Komunikim dhe Ndërgjegjësim përhap informacion në kohë dhe nxit dialogun për punën e DHSK-së. Në fletinformacionet për DHSK-në që shpërndahen gjatë veprimtarive publike ose u jepen gazetarëve, shpjegohen tema konkrete dhe procedura të rëndësishme.

Nëpërmjet angazhimit dhe komunikimit aktiv me organizatat joqeveritare dhe organizata të tjera të shoqërisë civile të Kosovës, si dhe me komunitete të ndryshme, DHSK-ja synon t'u përgjigjet disa prej sfidave të komunikimit që lidhen me administrimin e procedurave të zhvendosura. Synimi është nxitja e komunikimit të drejtpërdrejtë me shoqërinë kosovare përmes një rrjeti për informim që komunikon me shoqërinë civile, pakicat, rininë, juristët, mediat dhe të tjerët.

Synimet afatshkurtra:

- të sigurojë që mandati dhe puna e DHSK-së të kuptohen;
- të punojë aktivisht për komunikimin dhe ndërgjegjësimin e pjesëve të ndryshme të shoqërisë, në veçanti të komuniteteve të prekura në rajon dhe sidomos të viktimave dhe dëshmitarëve të mundshëm;
- të përfshijë komunitetet përkatëse në dialog;
- të menaxhojë pritshmëritë përmes ofrimit të informacioneve të sakta;
- të sigurojë që DHSK-ja të perceptohet si një institucion gjyqësor i pavarur dhe i paanshëm.

Synimet afatgjata:

- të sigurojë që trashëgimia e DHSK-së do të perceptohet si e besueshme dhe e paanshme;
- të zhvillojë mekanizma efikasë komunikimi dhe ndërgjegjësimi, të cilët mund të shërbejnë si shembull edhe për gjykata të tjera ndërkombëtare dhe të ndërkombëtarizuara.

Zbatimi i Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim

Viti 2018 ishte një vit aktiv gjatë të cilit DHSK-ja i ka shtuar ndjeshëm veprimtaritë e saj të komunikimit dhe ndërgjegjësimin, veçanërisht në Kosovë, në sajë të një kontributi bujar të qeverisë zvicerane. Gjatë harkut kohor të vitit, DHSK-ja zhvilloi 30 veprimtari komunikimi dhe ndërgjegjësimi në Kosovë dhe Serbi, me rreth

730 pjesëmarrës. Ndër to përfshihen tryeza të rrumbullakëta me gazetarë, takime me avokatë, studentë, grupe të rinjsh e të rejash, organizata të shoqërisë civile, si dhe prezantimi i Avokatit të Popullit të Dhomave të Specializuara të Kosovës. Në maj 2018, Administratorja zhvilloi vizitën e saj të parë në Serbi.

Disa veprimtari komunikimi dhe ndërgjegjësimi

- Takim i koordinatorit të Zyrës së Mbrojtjes dhe shefes së Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave me pjesëtarë të Odës së Avokatëve të Kosovës - Prishtinë, shkurt 2018
- Ligjëratë në fakultetin e drejtësisë të Universitetit të Prizrenit, organizuar në bashkëpunim me Fondin për të Drejtën Humanitare Kosovë - Prizren, prill 2018
- Paraqitja e mandatit të DHSK-së në takimin vjetor të Rrjetit të Grave të Kosovës me afërsisht 115 përfaqësuese nga grupet e grave - Prishtinë, mars 2018
- Takime konsultative të Administratores, Dr. Fidelma Donlon, me shoqërinë civile, OJQ dhe organizata ndërkombëtare të ndryshme - Beograd, maj 2018.

Më 21 mars 2018, DHSK-ja në bashkëpunim me Fondin për të Drejtën Humanitare (FDH) Kosovë, ftoi OJQ, juristë dhe përfaqësues të trupit diplomatik në një diskutim paneli në Prishtinë lidhur me mandatin e DHSK-së. Përfaqësues të Njësisë së Mbështetjes Juridike të Dhomave dhe të Zyrës Administrative shpjeguan mandatin dhe strukturën e DHSK-së dhe shpjeguan mënyrën e punës së DHSK-së për të siguruar procedura gjyqësore të drejta, të paanshme, të pavarura, efikase dhe të sigurta.



Diskutimi i panelit të DHSK-së me OJQ dhe shoqërinë civile

Disa veprimtari komunikimi dhe ndërgjegjësimi

- Takimi i parë i Rrjetit për Informim të Gjykatës, ku u dhanë mendime mbi sugjerime konkrete të bëra më herët në lidhje me aktivitetet e ardhshme komunikuese dhe ndërgjegjësuere – Hagë, qershor 2018
- Takim me shoqërinë civile, organizuar në bashkëpunim me Qendrën Evropiane për Çështje të Pakicave – Obiliq, qershor 2018
- Tryezë e rrumbullakët, organizuar në bashkëpunim me Nismën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Prishtinë, shtator 2018
- Prezantimi i Avokatit të Popullit të Dhomave të Specializuara në Kosovë, përmes intervistave në media – Prishtinë, tetor 2018
- Takime dhe diskutime në tryezë të rrumbullakët me shoqërinë civile dhe një ligjërata në Universitetin e Pejës, organizuar në bashkëpunim me OJQ-të e Kosovës – në disa vende në Kosovë, përfshirë Graçanicën, Gjilanin dhe Pejën, dhjetor 2018.

Ngritja e Rrjetit për Informim të Gjykatës

Hapi i parë për zbatimin e Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim të DHSK-së për vitin 2018 ishte ngritja e Rrjetit për Informim të Gjykatës (RRIGJ), një rrjet jozyrtar i OJQ-ve që ndihmon DHSK-në me komente të rregullta në lidhje me programin dhe veprimtaritë e komunikimit dhe ndërgjegjësimin, dhe që ofron vullnetarisht njohuritë e veta mbi komunitetet e prekura dhe ekspertizën e komunikimit në lidhje me qasjet më të mira për komunikim dhe ndërgjegjësim. Përveç kësaj, OJQ-të që janë pjesë e RRIGJ-së ndihmojnë në përhapjen e mesazheve kyçe përmes organizimit të takimeve, ku DHSK-ja mund të japë informacion dhe të angazhohet me shoqërinë civile.

Në qershor 2018, 15 OJQ nga Kosova dhe Serbia që janë anëtare të RRIGJ-së, morën pjesë në seminarin për komunikim dhe ndërgjegjësim të organizuar nga DHSK-ja në Hagë. Ndonëse

rrjeti mund të ndryshojë dhe zgjerohet, OJQ-të që morën pjesë në seminar përbëjnë grupin bazë të tij. Kryetarja dhe Administratorja e DHSK-së mirëpritën pjesëmarrësit në seminar dhe në fjalët e tyre theksuan rolin e rëndësishëm të OJQ-ve në nxitjen e dialogut midis DHSK-së dhe shoqërisë civile. Ato i nxitën OJQ-të të jepnin mendimet e tyre për veprimtaritë e kaluara të komunikimit dhe ndërgjegjësimin dhe të bënin sugjerime për nisma të ardhshme të komunikimit dhe ndërgjegjësimin në rajon, përfshirë edhe metodat e komunikimit.

Seminari, i cili u ofroi OJQ-ve partnere mundësinë që të takoheshin drejtpërdrejt me drejtues dhe punonjës të DHSK-së, arriti tre objektiva kryesore:

- DHSK-ja e përdori seminarin si mundësi për të zhvilluar takimin e parë të RRIGJ-së;



Anëtarët e Rrjetit për Informim të DSK-së – qershor 2018

- Pjesëmarrësit morën informacion të hollësishëm për mandatin dhe punën e DSK-së drejtpërdrejt nga punonjësit e njësive të ndryshme të DSK-së. Ata u nxitën të bënin pyetje dhe të sqaronin keqkuptimet, si edhe të diskutonin aspektet ligjore të mandatit dhe të procedurave të DSK-së, me synimin që të merrnin informacion më të saktë të cilin të mund t'ua shpërndanin kontakteve të tyre në rajon;
- Gjatë mbledhjeve më të vogla në grupe pune, pjesëmarrësit i shprehën DSK-së komentet e tyre në lidhje me Programin për Komunikim dhe Ndërgjegjësim dhe dhanë sugjerime konkrete për përmirësimin e punës komunikuese dhe ndërgjegjësuere me komunitetet e ndryshme. Rezultatet e seminarit e ndihmuan DSK-në në hartimin e aktiviteteve të ardhshme të komunikimit dhe ndërgjegjësimin.

Kontaktet me studentët dhe juristët

Programi për Vizitorë, i krijuar në vitin 2016, vijon të mirëpresë juristë dhe studentë në DSK. Gjatë 2018, përfaqësues të DSK-së dhe të ZPS-së u kanë folur grupeve të vizitorëve për punën e tyre si dhe u kanë shpjeguar mandatin e të dy institucioneve. Vizitorët gjithashtu kanë pasur mundësinë të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë për tema që lidhen me DSK-në dhe ZPS-në.

Në 2018, në këtë program morën pjesë afërsisht 700 studentë nga 35 universitete të ndryshme të Evropës, Amerikës së Veriut dhe të Jugut. Ndër të tjerë, studentët u takuan me përfaqësues të NJMJDH-së, të kabinetit të Administratores, Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave dhe të ZPS-së.



Programi për Vizitorë i DHSK-së

Gjithashtu, Kryetarja, Administratorja dhe punonjës të ndryshëm kanë mbajtur fjalime të rëndësishme dhe kumtesa në universitete dhe në konferenca. Me rëndësi të veçantë ishte përfaqësimi i DHSK-së në Konferencën e Katërt Vjetore të Specializuar të Shoqatës Ndërkombëtare të Avokatëve për të Drejtën Penale Ndërkombëtare dhe në sesionin e 12-të të Institutit Brandeis për Gjykatësit Ndërkombëtarë. Angazhimi në fushat profesionale dhe akademike siguron mundësi për komunikim të drejtpërdrejtë dhe për përhapjen më të gjerë të informacionit mbi punën e DHSK-së dhe ZPS-së.



Seminari për gazetarë në Akademinë Ndërkombëtare të Parimeve të Nurembergut

Në nëntor 2018, DHSK-ja dhe Akademia Ndërkombëtare e Parimeve të Nurembergut ftoi 20 gazetarë nga Kosova për të marrë pjesë në një seminar katërditor për të drejtën penale ndërkombëtare dhe raportimin e proceseve gjyqësore. Përfaqësues të DHSK-së, ekspertë të së drejtës ndërkombëtare, si edhe gazetarë ndërkombëtarë u angazhuan në diskutime me gazetarët nga Kosova në lidhje me aspekte të ndryshme të këtij lloji raportimi kompleks. Një nga temat qendrore të seminarit ishte rëndësia e raportimit të drejtë dhe të paanshëm të proceseve gjyqësore. DHSK-ja theksoi gjithashtu angazhimin për t'i dhënë përgjigje në kohë pyetjeve të mediave, sipas rrethanave.



Monitorimi dhe vlerësimi i Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim të DHSK-së

DHSK-ja ka dy mekanizma për vlerësimin e ndikimit dhe efikasitetit të Programit të saj për Komunikim dhe Ndërgjegjësim: mbledhja e mendimeve të OJQ-ve vendore dhe anketimet publike vjetore të kryera në Kosovë dhe Serbi.

Në përgjigje të komenteve dhe mendimeve të çmuara që ka marrë, në vitin 2018 DHSK-ja e shtoi numrin e takimeve dhe veprimtarive të mbajtura me OJQ-të dhe shoqërinë civile, si në Kosovë ashtu edhe në Serbi. Me qëllim ofrimin e materialeve informuese që nuk u drejtohen vetëm juristëve, u përpiluan një numër flet-informacionesh që përshkruajnë në mënyrë të përmbledhur punën e DHSK-së. Gjithashtu, edhe faqja e internetit e DHSK-së u zhvillua më tej për të siguruar një qasje më të gjerë në procedurat e DHSK-së. Faqja e ripunuar e internetit, që u përrua në nëntor të 2018, tani bën të mundur transmetimin e përmbajtjeve audiovizuale në gjuhët zyrtare të DHSK-së -

shqipe, serbishte dhe anglishte - të seancave gjyqësore dhe aktiviteteve të tjera. Gjithashtu, faqja e internetit është ndërtuar në mënyrë të tillë që në të ardhmen të përfshijë edhe praninë e DHSK-së në mediat sociale.

Anketimet vjetore të kryera në Kosovë dhe Serbi i japin mundësi DHSK-së të vlerësojë njohuritë dhe qëndrimet në lidhje me të. Anketimi më i fundit i bërë në maj 2018 tregon një njohje dhe ndërgjegjësim më të madh në lidhje me DHSK-në në Serbi, krahasuar me anketimin e bërë në 2017 (41% krahasuar me 24%). Në Kosovë, 61% e të anketuarve në 2018 shprehën mbështetje për punën e DHSK-së.

ZYRA ADMINISTRATIVE

Zyra Administrative, e drejtuar nga Administratorja, ushtron një sërë funksionesh të shumëllojshme mbështetëse administrative dhe gjyqësore. Sipas nenit 34 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Zyra Administrative është përgjegjëse për shërbimet që lidhen me Dhomat



Administratorja Fidelma Donlon

e Specializuara të Kosovës dhe të gjitha funksionet e nevojshme dhe të ndërlydhura. Kjo përfshin edhe ofrimin e mbështetjes administrative për punën e Dhomave dhe ZPS-së në fushën e buxhetit, financave, prokurimit, burimeve njerëzore, dhe sigurisë. Funksionet e mbështetjes gjyqësore përfshijnë mbështetjen dhe mbrojtjen e dëshmitarëve, administrimin e ndihmës juridike dhe të sistemeve të pjesëmarrjes së viktimave, shërbimin e përkthimit meshkrim dhe gojë dhe administrimin e gjykatës. Administratorja është gjithashtu përgjegjëse për administrimin e objektit të paraburgimit të DHSK-së dhe për funksione të ndryshme të jashtme diplomatike, përfshirë negocimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me shtetet.

Dr. Fidelma Donlon u emërua në postin e Administratorës në prill 2016. Dr. Donlon është autoriteti më i lartë administrativ brenda DHSK-së. Si e tillë, ajo është përgjegjëse për administrimin e procedurave të zhvendosura dhe, në këtë kuadër, ajo nënshkruan marrëveshjet e subvencionimit me Komisionin Evropian që rregullojnë financimin e DHSK-së dhe ZPS-së. Dr. Donlon administron përdorimin e fondeve të akorduara nga shtetet anëtare të BE-së dhe nga shtetet e treta kontribuese, duke siguruar përdorimin e tyre në mënyrë të përgjegjshme. Zëvendësadministratori, Dr. Guido Acquaviva, e ndihmon Administratorën në kryerjen e funksioneve të saj.


Sikundër parashikohet në Marrëveshjen me Shtetin Pritës, Administratorja përfaqëson institucionet e zhvendosura në Holandë dhe në këtë cilësi ajo është në kontakt me institucionet holandeze si Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Drejtësisë dhe Sigurisë dhe autoritetet vendore të qytetit të Hagës. Gjithashtu, ajo mban kontakte me përfaqësues të shteteve anëtare të BE-së, të shteteve të treta kontribuese dhe me anëtarë të tjerë të komunitetit diplomatik në Hagë. Ajo bashkëpunon edhe me Misionin e BE-së

për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), Përfaqësuesen e Posaçme të BE-së në Kosovë, anëtarët e komunitetit diplomatik në Kosovë, si edhe me Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës.

Në 2018, Administratorja vizitoi Kosovën dhe Serbinë ku mori pjesë dhe foli në një numër aktivitetesh, përfshirë edhe në një konferencë të Shoqatës Ndërkombëtare të Avokatëve të mbajtur në prill, në një seminar për gazetarë në nëntor, dhe në Asamblenë e Shteteve Palë të Gjykatës Penale Ndërkombëtare në dhjetor.

Zyra Administrative përfshin kabinetin e Administratores, Njësinë për Informim dhe Komunikim me Publikun, Zyrën e Auditimit, si dhe dy seksione – Seksionin e Shërbimeve Gjyqësore dhe Seksionin e Administratës. Po kështu, në Zyrën Administrative, përfshihet edhe Zyra e pavarur e Avokatit të Popullit.

Në vitin 2018, Administratorja iu bashkua Mbrojtësve Ndërkombëtarë të Barazisë Gjinore, një rrjet drejtuesish i përbërë nga vendimmarrës femra dhe meshkuj të vendosur për të rrëzuar barrierat gjinore dhe për ta bërë barazinë gjinore një realitet pune në sferat e tyre të influencës. Administratorja ka ngritur një komitet të koordinimit gjinor, si një forum ku punonjësit dhe punonjëset të shkëmbejnë përvojat e tyre dhe të japin rekomandime për avancimin e mëtejshëm të barazisë gjinore në DHSK.



1. Kabineti i Administratores (KA)

Kabineti i Administratores (KA) mbështet punën e Administratores dhe të zëvendës-administratorit. KA-ja ofron këshilla juridike lidhur me mandatin e DHSK-së dhe procedurat administrative, si edhe mbështetje në mbajtjen e kontakteve me shtetin pritës, BE-në dhe shtetet anëtare, shtetet e treta kontribuese dhe me misionet diplomatike dhe organizata të tjera. KA-ja është gjithashtu përgjegjëse për hartimin dhe mbikëqyrjen e rregullave për administrimin e sistemit të informacionit të DHSK-së.

Këshilltari juridik i KA-së ofron këshilla juridike për një larmi temash, përfshirë zbatimin e Marrëveshjes me Shtetin Pritës, si dhe në lidhje me dokumente të brendshme si Rregullorja për Punonjësit dhe Kodi i Etikës Profesionale për Punonjësit, privilegjet dhe imunitetet, bashkëpunimin me shtetet, dhe rregulloret administrative të brendshme të Zyrës Administrative.

Gjatë vitit 2018, u forcuan rregulloret e brendshme në fushën e administrimit të burimeve njerëzore, sigurisë, mbrojtjes së informacionit dhe të financës. DHSK-ja gjithashtu ka përcaktuar procedurën e plotë të rishikimit brenda institucionit të vendimeve të Administratores dhe të apelimit të tyre.

Në kuadër të KA-së, ekipi për administrimin e informacionit (AdInf) siguron përdorimin e një qasjeje të harmonizuar dhe gjithëpërfshirëse për administrimin e informacionit në nivel të DHSK-së, duke ofruar këshilla strategjike për administrimin efikas dhe të sigurt të informacionit dhe zbatimin efektiv të tij. Administrimi efikas i informacionit, i dokumenteve dhe arkivave

të DHSK-së mbron sigurinë e informacionit të ndjeshëm dhe siguron pavarësinë gjyqësore, drejtësinë, efikasitetin dhe trashëgiminë institucionale në përputhje me standardet më të larta të drejtësisë ndërkombëtare.

AdInf shërben si qendër për dhënien e këshillave lidhur me pajtueshmërinë ligjore në fushat e përdorimit të të dhënave digjitale, fizike dhe audiovizuale dhe administrimin e dokumenteve dhe të arkivave për të gjitha funksionet administrative dhe gjyqësore të DHSK-së. Në vitin 2018 u miratuan strategji për ruajtjen digjitale të materialeve audiovizuale.

Ekipi AdInf, së bashku me njësinë e shërbimeve të teknologjisë së informacionit, ka vijuar të përmirësojë më tej kontrollet e sigurisë së teknologjisë së informacionit përmes organizimit të seancave për informimin e punonjësve dhe praktikantëve të rinj në lidhje me sigurinë e informacionit, administrimit të ndryshimeve në lejet e përdorimit, ofrimit të shërbimeve të kodimit dhe dekodimit, dhe kryerjes së vlerësimeve të rreziqeve. Gjithashtu, AdInf ka ofruar këshilla mbi respektimin e standardeve të mbrojtjes së të dhënave për një larmi të gjerë të aktiviteteve të punës.

Në vitin 2018, Administratorja nxori dy përditësime në plotësim të rregulloreve të brendshme për administrimin e aseteve të informacionit, që përmbajnë hollësi të mëtejshme lidhur me mbrojtjen e të dhënave dhe kërkesat për qasje në të dhënat personale. Gjithashtu, ajo nxori një udhëzim mbi trajtimin e të dhënave të klasifikuara.

Biblioteka e DHSK-së

- Në 2018, biblioteka e DHSK-së filloi përdorimin e Sistemit të integruar bibliotekar për ndjekjen e qarkullimit të materialeve të fondit të bibliotekës, si dhe të Platformës elektronike të kërkimit e cila ndihmon gjatë hulumtimeve. Në kuadër të projektit, dy sistemet u integruan dhe optimizuan dhe u bë regjistrimi i të dhënave për të gjithë fondin, përfshirë të dhënat bibliografike. Me një klikim në mjetin e kërkimit, të gjitha burimet shfaqen në një portal të vetëm i cili është i disponueshëm për të gjithë punonjësit e DHSK-së dhe ZPS-së, si edhe për pjesëmarrësit në procedurat para DHSK-së. Këto mjete zvoglojnë në mënyrë të efektshme kostot e shërbimit të bibliotekës dhe sigurojnë qasje më të madhe në burimet e të dhënave.
- Biblioteka ka blerë afërsisht 600 libra të rinj nga fushat e së drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës së BE-së, kriminologjisë, shkencave politike, studimeve gjuhësore dhe disiplinave të tjera të lidhura me punën dhe nevojat e DHSK-së dhe ZPS-së. Koleksioni i bibliotekës tani përmban mbi 1.200 publikime për përdorim.
- Ndër burimet e reja elektronike të siguruar përfshihen abonime në burime enciklopedike të njohura në mbarë botën, periodikë të botuesve të rëndësishëm ligjorë, pothuaj 400 libra të rinj elektronikë, raporte akademike në fushën e drejtësisë dhe jurisprudencë të gjykatave. Gjithashtu biblioteka ka blerë edhe disa libra mbi standardet ndërkombëtare për mbështetjen e praktikave më të mira.
- Burimet mund të merren hua edhe nga biblioteka të tjera, përfshirë Bibliotekën e Pallatit të Paqes në Hagë.
- Përfaqësues të ekipit të Administrimit të Informacionit janë anëtarë të një grupi kolegësh që punojnë për të gjetur zgjidhje për çështjet me të cilat përballen bibliotekat e gjykatave ndërkombëtare dhe ofrimin e mbështetjes së ndërsjellë në rajonin e Hagës.

2. Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun (NJKP)

Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun (NJKP) drejton marrëdhëniet e jashtme dhe programin për komunikim dhe ndërgjegjësim të DHSK-së. Synimi i kësaj njësie është rritja e njohurive dhe të kuptuarit e mandatit të DHSK-së në përputhje me strategjinë për komunikim dhe ndërgjegjësim

të DHSK-së. Njësia përpaket të organizojë takime të përmuajshme komunikimi dhe ndërgjegjësimi me shoqërinë civile në Kosovë, për të vazhduar dialogun rreth temave të tilla si mandati i DHSK-së dhe zhvillimet aktuale. Po ashtu, në 2018, NJKP-ja nisi një dialog me shoqërinë civile në Serbi.



Shefja e NJKP, shefja e Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave dhe përfaqësuesi i Njësisë së Mbështetjes Juridike të Dhomave në një aktivitet komunikimi dhe ndërgjegjësimi në Prizren – prill 2018

NJKP merr rregullisht pyetje nga mediat dhe u përgjigjet atyre pa vonesë, për të siguruar përhapjen e saktë dhe në kohë të informacionit. Për të mundësuar raportim objektiv dhe të saktë, në nëntor 2018 NJKP organizoi për gazetarët e Kosovës një seminar katërditor mbi drejtësinë penale ndërkombëtare dhe raportimin gjyqësor (*shih më lart, Programi për Komunikim dhe Ndërgjegjësim*).

Po në nëntor 2018, u ripunua faqja e internetit në tri gjuhët e DHSK-së, duke i shtuar tipare të reja si funksioni i kërkimit të dokumenteve të gjykatës, dhënia e informacioneve në Twitter, si

edhe mundësia për të transmetuar përmbajtje audiovizuale gjatë seancave publike të gjykatës dhe aktiviteteve të tjera në gjuhët zyrtare të DHSK-së - shqipe, serbishte dhe anglishte. Synimi është që procedurat para DHSK-së të mund të përcillen nga çdo vend i botës përmes lidhjes me internet. Faqja e re e internetit përfshin gjithashtu një arkiv të dokumentacionit gjyqësor publik (DGJP) të DHSK-së, në tri gjuhët zyrtare. Ndër risitë e arkivit elektronik përfshihen mundësia e kërkimit të llojeve të ndryshme të dokumenteve sipas shkallës së gjykatës dhe shfaqja automatike e parashtrimeve të protokolluara që lidhen me to.

3. Zyra e auditimit

Audituesja e brendshme kontribuon në administrimin dhe llogaridhënien institucionale të DHSK-së dhe ZPS-së përmes kryerjes së auditimeve të brendshme dhe raportimit të konstatimeve dhe rekomandimeve tek Administratorja. Në punën e vet, audituesja u përmbahet standardeve ndërkombëtare profesionale të auditimit të brendshëm dhe rregulloreve financiare të BE-së, dhe propozon masa për administrim më të mirë të punës.

Gjatë periudhës së raportimit, audituesja e brendshme ka kryer nëntë auditime dhe katër auditime plotësuese, në përputhje me planet e auditimit të brendshëm. Përveç auditimit të financave, prokurimit, administrimit të burimeve njerëzore dhe të bazës materiale si në Zyrën Administrative ashtu edhe në ZPS, audituesja e brendshme ka shqyrtuar edhe procedurën e administrimit të lejeve për qasje në skedarët e përbashkët të DHSK-së.

4. Zyra e Avokatit të Popullit



Avokati i Popullit Pietro Spera

Avokati i Popullit, ndonëse në aspektin organizativ është brenda Zyrës Administrative, vepron në mënyrë të pavarur për të monitoruar, mbrojtur dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të personave që ndërveprojnë me DHSK-në dhe ZPS-në. Ngritja e Zyrës së Avokatit të Popullit brenda strukturës së DHSK-së dhe ZPS-së është diçka e veçantë, në kuptimin që kjo zyrë ofron një instancë shtesë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave që ndërveprojnë me këto institucione.

Pietro Spera u emërua Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës në maj të vitit 2018. Pas emërimit të tij, Avokati i Popullit Spera nënshkroi deklaratën solemne përpara Administratores më 29 maj 2018, sikurse kërkohet në Rregulloren e Procedurës dhe të Provave.

Në kuadër të funksioneve të veta, Zyra e Avokatit të Popullit ka përcaktuar procedurën e plotë për parashtrimin e ankesave, përmes së cilës individët që ndërveprojnë me DHSK-në apo ZPS-në mund të paraqesin ankesa për shkelje të të drejtave të tyre themelore kushtetuese nga këto dy institucione. Pas marrjes së ankesës, Avokati i Popullit e shqyrton përmbajtjen e saj dhe, kur është e përshtatshme, kryen hetime për shkeljet e pretenduara. Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit nxjerr një raport përfundimtar me rekomandime për Kryetaren e DHSK-së, apo për Prokurorin e Specializuar, sipas rastit. Avokati i Popullit e miratoi procedurën e ankesave në shtator të 2018.

Që prej emërimit të tij, Avokati i Popullit ka krijuar faqen e Avokatit të Popullit në faqen e Internetit të DHSK-së, e cila përmban informacion mbi procedurën e ankesave, që përshkruan me imtësi procedurën që duhet ndjekur për paraqitjen e ankesave dhe mënyrën e trajtimit të ankesave nga Avokati i Popullit.

Në kuadrin e funksionit monitorues të tij, Avokati i Popullit mund t'i japë gjithashtu DHSK-së dhe ZPS-së edhe këshilla në vijimësi, me qëllim sigurimin e respektimit të plotë të

standardeve më të larta të të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit nuk ndërhyt në proceset gjyqësore para DHSK-së, përveçse në raste vonesash të paarsyeshme apo kur ftohet si *amicus curiae*, mik i gjykatës.

Avokati i Popullit duhet t'i kryejë detyrat e veta në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe me profesionalizëm, dhe të veprojë në përputhje me karakterin e lartë moral sikurse kërkohet nga Kushtetuta e Kosovës, Ligji dhe Rregullorja e Procedurës dhe e Provave. Standardet profesionale të zbatueshme për punën e Zyrës së Avokatit të Popullit rregullohen me Kodin e Etikës për Avokatin e Popullit, që gjendet në faqen e internetit të DHSK-së, të cilin ai e miratoi në shtator 2018.

Me emërimin e Avokatit të Popullit, Zyra është plotësisht funksionale dhe deri tani ka marrë një numër ankesash nga individë. Ankesat trajtohen në përputhje me Rregulloren e Procedurës dhe të Provave dhe procedurën për parashtrimin e ankesave.

Në tetor 2018, Avokati i Popullit bëri vizitën e tij të parë në Kosovë, ku dha një numër intervistash televizive. Ai i bëri një vizitë kortezie edhe Avokatit të Popullit të Kosovës.

5. Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore

Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore përbëhet nga katër njësi dhe tri zyra, të cilat sigurojnë mbështetjen e nevojshme juridike dhe operative për DHSK-në dhe ZPS-në: Njësia për Administrimin e Gjykatës; Njësia e Përkthimit; Zyra e Mbrojtjes; Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave; Zyra për Mbrojtjen

dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve; Njësia e Paraburgimit; dhe Njësia e Mbështetjes Juridike të Dhomave. Puna e ekipit të Njesisë së Mbështetjes Juridike të Dhomave është trajtuar më lart në kapitullin kushtuar Dhomave.

5.1 Njësia për Administrimin e Gjykatës (NJAGJ)

Njësia për Administrimin e Gjykatës (NJAGJ) administron dokumentacionin gjyqësor, të gjitha parashtrimet e protokolluara dhe provat fizike të DHSK-së. Njësia përdor një sistem elektronik të administrimit të punës gjyqësore, të quajtur *Legal Workflow*, i cili u mundëson gjykatësve, palëve dhe pjesëmarrësve në procedura që të marrin, të ruajnë dhe të shpërndajnë dokumentacionin e çështjeve në mënyrë elektronike. Sistemi gjithashtu bën të mundur që përdoruesit të shohin, analizojnë, nxjerrin dhe paraqesin të gjitha provat brenda një sistemi të vetëm të integruar. Gjatë gjithë 2018, u përpunuan më tej funksionet e *Legal Workflow* që lidhen me administrimin e parashtrimeve të protokolluara, krijimin e një evidence të hollësishme të veprimeve procedurale, ruajtjen e informacionit statistikor dhe krijimin e kalendarit të gjykatës. Këto përmirësime, së bashku me meta-të dhënat dhe ndryshimet procedurale, rrisin saktësinë e informacionit, efikasitetin, si dhe aftësitë

raportuese. Sistemi gjithashtu ofron një mjet për nxjerrjen e dokumenteve publike në ndërfaqen e arkivit të faqes së re të internetit të DHSK-së.

Arkivi i dokumentacionit gjyqësor publik mundëson kërkime në të tri gjuhët zyrtare, në bazë të tekstit të plotë apo numrit të parashtrimit të protokolluar, por edhe në bazë të dispozitave konkrete të Rregullores së Procedurës dhe të Provave dhe të Ligjit. Ai është krijuar në mënyrë të tillë që t'u përgjigjet kërkesave të publikut në përgjithësi si edhe atyre të komuniteteve akademike dhe juridike.

Një objektivi kyç i NJAGJ-së në vitin 2018 ishte përgatitja e infrastrukturës së sallës së gjyqit në ndërtesën e re të gjykatës dhe në bashkëpunim me njësitë e tjera të Zyrës Administrative, përgatitja për testimin e sallës së gjyqit me marrjen në dorëzim të ndërtesës nga shteti pritës.

Arkivi i dokumentacionit gjyqësor publik në faqen e Internetit të DHSK-së i lejon gjithkujt që viziton faqen e internetit që të bëjë kërkime në dokumentacionin publik të gjykatës. Arkivi është i lehtë në përdorim dhe mundëson kërkime në tri gjuhët zyrtare.

5.2 Njësia e Përkthimit (NJP)

Njësia e Përkthimit (NJP) ofron shërbime përkthimi me gojë dhe me shkrim në tri gjuhët zyrtare të DHSK-së. Për të respektuar angazhimin ndaj publikut në rajon, njësia i përkthen të gjitha materialet njëkohësisht në të tri gjuhët.

Njësia e Përkthimit ofron përkthim të njëkohshëm me gojë në gjykatë, si edhe përkthime gjatë misionëve të DHSK-së dhe aktiviteteve të tjera të organizuara nga partnerët e jashtëm. Në vitin 2018, kjo njësi prodhoi rreth 1.000 faqe përkthime, përfshirë përkthime të përmbajtjes së faqes së internetit të DHSK-së, deklarata shtypi, fletinformacione dhe paketa informuese.

Në vitin 2018, ekipi i NJP-së ka nxjerrë rreth 1.000 faqe përkthime në përgjigje të 270 kërkesave për përkthim. Përveç përkthimeve, NJSHGJ-ja ka redaktuar rreth 1.200 faqe.

Gjithashtu u finalizua Kodi i etikës profesionale për përkthyesit me gojë e me shkrim dhe, pas miratimit të tij nga Administratorja, i gjithë personeli i NJP-së nënshkroi deklaratën solemne.

Në 2018 u miratua Kodi i etikës profesionale për përkthyesit me gojë dhe me shkrim, ku përfshihet deklarata solemne të cilën duhet ta bëjnë të gjithë përkthyesit para marrjes së detyrës.

Gjatë vitit 2018, NJP-ja nisi të përdorë një program kompjuterik për administrimin e kërkesave për përkthim, në shërbim të të gjithë institucionit, i cili automatizon administrimin e kërkesave dhe dorëzimin e përkthimeve dhe është i lidhur me sistemin elektronik të administrimit të punës gjyqësore, *Legal Workflow*.

Për të lehtësuar procesin e përkthimit, NJP-ja filloi përdorimin e programit kompjuterik të përkthimit MultiTrans dhe vuri në përdorim modulin Workflow, i cili i shërben të gjithë institucionit dhe automatizon procesin e kërkesave për përkthime, administrimin e kërkesave dhe dorëzimin e përkthimeve të përfunduara parashtruesve të kërkesave.

5.3 Zyra e Mbrojtjes (ZM)

Ligji garanton mbrojtjen e parimeve të gjykimit të drejtë për të dyshuarit dhe të akuzuarit para DHSK-së. Një mbrojtje e fortë është thelbësore për të garantuar një gjykim të drejtë; detyrat e Zyrës së Mbrojtjes (ZM), sikurse parashikohet në Ligj, pasqyrojnë përkushtimin e DHSK-së ndaj parimeve të gjykimit të drejtë. Nuk mund të ketë gjykim të drejtë pa pasur avokatë mbrojtës të kualifikuar. ZM-ja është asnjëse dhe nuk

merr pjesë në paraqitjen dhe argumentimin e fakteve të çështjeve para DHSK-së.

ZM-ja ka për detyrë të administrojë Listën e Mbrojtësve që plotësojnë kriteret për ushtrimin e profesionit para DHSK-së. Gjithashtu, Zyra ka për detyrë të administrojë sistemin e ndihmës juridike për përfaqësimin e të dyshuarve apo të akuzuarve të varfër apo pjesërisht të varfër para DHSK-së.

Gjatë 2018, ZM-ja ka punuar për të siguruar mbrojtjen efektive të të gjitha garancive të gjykimit të drejtë të mishëruara në Ligj, si dhe përmbushjen e standardeve më të larta ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në të gjitha procedurat ligjore të zbatueshme për mbrojtësit dhe për vetë Zyrën.

Që nga miratimi i Direktivës për Mbrojtësit në nëntor 2017, në faqen e DHSK-së në Internet është shpallur ftesa për paraqitjen e kërkesave për t'u përfshirë në Listën e Mbrojtësve. Në dhjetor 2018, në Listën e kombinuar të Mbrojtësve kishte gjithsej 118 avokatë, nga të cilët 62 mbrojtës për të dyshuar dhe të akuzuar dhe 34 që janë të gatshëm të jenë njëherazi mbrojtës për të dyshuar dhe të akuzuar dhe mbrojtës të viktimave. ZM-ja vazhdon të marrë dhe shqyrtojë në vijimësi kërkesa të reja për praninë në Listë.

ZM-ja gjithashtu i ka përqendruar përpjekjet e saj në ngritjen e një sistemi të ndihmës juridike që përmbush standardet e gjykimit të drejtë dhe



Koordinatori i Zyrës së Mbrojtjes

kriteret e miradministrimit financiar. Po kështu, paralelisht me krijimin e organit përfaqësues të pavarur të mbrojtësve (OPP), i ngritur në mënyrë të pavarur nga mbrojtësit e Listës, u hartua edhe një version i Kodit të etikës profesionale për mbrojtësit dhe prokurorët, i cili përmes grupit të punës u është shpërndarë mbrojtësve për qëllime konsultimi.

Mbrojtësit në procedurat para DHSK-së duhet të veprojnë në pajtim me Kodin e etikës profesionale për mbrojtësit dhe prokurorët. Ky dokument deontologjik rregullon sjelljen profesionale në procedurat gjyqësore para DHSK-së, për sigurimin e integritetit të procedurave dhe administrimin e drejtë dhe të duhur të drejtësisë. Ai zbatohet për të gjithë mbrojtësit dhe prokurorët që paraqiten para DHSK-së, si edhe për anëtarët e ekipeve të tyre.

5.4 Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave (ZPV)

Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave (ZPV) administron sistemin e pjesëmarrjes së viktimave dhe Listën e Mbrojtësve të Viktimave që kanë të drejtë të paraqiten para DHSK-së, si edhe sistemin e pagesave për përfaqësimin e viktimave.

Sipas Ligjit, viktimat marrin pjesë në një apo më shumë grupe dhe ushtrojnë të drejtat e tyre përmes mbrojtësve që u caktohen.


Kush mund të jetë viktimë pjesëmarrëse në procedurat para DHSK-së?

Pas konfirmimit të aktakuzës, çdo person që ka pësuar dëm fizik, mendor apo material si rezultat i drejtpërdrejtë i një krimi të renditur në aktakuzë, mund t'i bëjë kërkesë një gjykatësi për t'u pranuar si viktimë pjesëmarrëse. Personi duhet të ketë pësuar dëm si pasojë e krimeve të kryera ndërmjet viteve 1998 dhe 2000 dhe dëmi duhet të jetë i lidhur me pretendimet që përmban Raporti i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës i 7 janarit 2011.

Pas miratimit të Direktivës për Mbrojtësit në vitin 2017, e cila parashikon kriteret për praninë në Listën e Mbrojtësve, e deri në dhjetor të vitit 2018, ZPV-ja ka miratuar 56 mbrojtës që përmbushin kriteret dhe që si rrjedhojë kualifikohen si mbrojtës të viktimave, ose si mbrojtës të specializuar dhe të viktimave. ZPV-ja vijon të nxisë juristët me kualifikime të përshtatshme të bëjnë kërkesë për t'u pranuar në Listë.

Gjatë vitit 2018, ZPV-ja, së bashku me Zyrën e Mbrojtjes, kanë komunikuar me komunitetin e juristëve të Kosovës për t'u shpjeguar Direktivën për Mbrojtësit si dhe procesin e aplikimit dhe kriteret që duhen plotësuar. Shefja e ZPV-së dhe koordinatori i Zyrës së Mbrojtjes po ashtu janë takuar me kryetarin e odës së avokatëve të Serbisë për t'i dhënë informacion mbi Direktivën.

Në 2018, ZPV-ja i shtoi përpjekjet për t'u dhënë informacion rreth pjesëmarrjes së viktimave OJQ-ve përkatëse dhe shoqërisë civile në rajon. Shefja e ZPV-së organizoi takime informative me përfaqësues të komuniteteve të viktimave të mundshme, për t'i ndërgjegjësuar rreth DHSK-së, rolit të ZPV-së, të drejtave të viktimave pjesëmarrëse dhe sistemit të pjesëmarrjes së viktimave. Gjithashtu, në bashkëpunim me NJIKP-në, njësia ka informuar OJQ, studentë, gazetarë dhe publikun e gjerë në kuadër të veprimtarive dhe përmes medias, për mënyrën se si viktimat mund të marrin pjesë në procedurat para Dhomave të Specializuara.



5.5 Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve (ZMMD)

Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve (ZMMD) është përgjegjëse për garantimin e sigurisë dhe mirëqenies së personave në rrezik për shkak të veprimtarisë së DHSK-së. ZMMD-ja ka përfshirë praktikën më të mira të institucioneve ligjzbatuese të vendeve të ndryshme si dhe të gjykatave të tjera që gjykojnë krime ndërkombëtare. Kjo është bërë për të siguruar pajtueshmërinë me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore dhe për të ruajtur drejtpeshimin midis nevojave të dëshmitarëve dhe personave të tjerë që kanë nevojë për mbrojtje, duke garantuar në të njëjtën kohë të drejtën për gjykim të drejtë.

Bashkëpunimi me shtetin pritës është me rëndësi themelore për organizimin dhe përgatitjen

efikase të udhëtimit të personave që kanë nevojë për mbrojtje. ZMMD-ja ka vendosur marrëdhënie të ngushta pune, procedura të standardizuara dhe marrëveshje praktike me autoritetet përkatëse holandeze. ZMMD-ja ka punuar gjithashtu për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për të mundësuar zbatimin e masave mbrojtëse përtej kufijve të një vendi dhe shkëmbimin e praktikave më të mira, si edhe për të dhënë ndihmë praktike për garantimin e mbrojtjes së personave. ZMMD-ja ka hartuar dhe vendosur udhëzimet e duhura mbështetëse dhe procedurat e vlerësimit për të siguruar që dëshmitarët të shprehin shqetësimet e tyre në lidhje me nevojat familjare, gjinore, kulturore, mjekësore apo nevoja të tjera të veçanta. Masat mbështetëse monitorohen dhe ndryshohen, sipas rastit, gjatë gjithë procedurave.

ZMMD-ja orvatet të përmbushë një standard të lartë të ndihmës, mbështetjes dhe këshillimit psikologjik për dëshmitarët, në përshtatje me nevojat e tyre, përfshirë edhe për dëshmitarët që janë të traumatizuar apo të cenuseshëm.

5.6 Njësia e Paraburgimit (NJP)

Njësia e Paraburgimit (NJP) drejton dhe administron objektin e paraburgimit të DHSK-së dhe siguron që personat e paraburgosur nën autoritetin e DHSK-së të mbahen në përputhje me standardet ndërkombëtare, praktikën më të mira dhe ligjet e zbatueshme, si dhe t'u mundësojë të paraburgosurve të marrin pjesë në procedura.

Njësia punon ngushtësisht me Shërbimin e Burgjeve të Holandës, personeli i të cilit drejton objektin e paraburgimit nën mbikëqyrjen e Njesisë. Personeli i NJP-së ofron shërbimet e administrimit, drejtimit dhe përkthimit në objektin e paraburgimit.

Në vitin 2018, DHSK-ja hartoi Rregulloren e Paraburgimit e cila, bashkë me udhëzime të tjera të brendshme, janë në harmoni me Rregulloren evropiane të burgjeve dhe me Rregullat standarde minimale të Kombeve të Bashkuara për trajtimin e të burgosurve - Rregullorja Mandela. Sikurse parashikohet në Ligj dhe në Rregulloren e Procedurës dhe të Provave, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, si edhe Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës, kanë të drejtë t'i inspektojnë objektet.

6. Seksioni i Administratës

Seksioni i Administratës ofron mbështetje administrative dhe teknike për DHSK-në dhe ZPS-në. Seksioni përbëhet nga gjashtë njësi: Burimet Njerëzore; Shërbimet e Teknologjisë së Informacionit; Administrimi i Objekteve dhe Shërbimet e Përgjithshme; Siguria; Financat

dhe Buxheti; dhe Prokurimi. Gjatë gjithë vitit 2018, Seksioni vijoi punën për zhvillimin e mëtejshëm të administratës së DHSK-së dhe realizimin e të gjitha shërbimeve mbështetëse për sigurimin e kapaciteteve të plota operative të institucionit.

6.1 Njësia e Burimeve Njerëzore (NJBNI)

Gjatë vitit 2018, Njësia e Burimeve Njerëzore (NJBNI) ka vazhduar t'i ofrojë mbështetje, këshilla dhe shërbime të gjithë personelit të DHSK-së dhe ZPS-së lidhur me çështje që kanë të bëjnë me burimet njerëzore, duke drejtuar procesin e rekrutimit, administrimin e pagave, sigurimet shëndetësore, fondin e kursimeve për pension dhe përfitime të tjera, mirëqenien dhe trajnimin e punonjësve, si edhe procesin e vlerësimit të punës së punonjësit.


Në 2018, rekrutimi dhe përzgjedhja e punonjësve të rinj të DHSK-së dhe ZPS-së vazhdoi të ishte një përparësi. U shpallën dy Ftesa për Aplikime (FpA) për vende të lira pune në të dy institucionet. Administrimi efektiv i FpA-ve dhe punësimi i personelit bazuar në nevojat operative, duke mbajtur parasysh barazinë gjinore dhe shpërndarjen gjeografike, rezultoi në zgjerimin e të dy institucioneve dhe në rritjen e përgjithshme të numrit të punonjësve nga 148 në 31 dhjetor 2017, në 180 më 31 dhjetor 2018. Po ashtu, përmes ftesës për praktikë profesionale, gjatë gjithë vitit NJBNI-ja bëri të mundur punësimin e 26 praktikantëve. Bazuar në autoritetin e Administratores dhe duke marrë parasysh nevojat e administrimit efikas të burimeve njerëzore dhe caktimin e punonjësve në përputhje me kërkesat e ngarkesës së punës në gjithë DHSK-në, në vitin 2018 u miratua një numër ri-caktimesh të përkohshme.

DHSK-ja dhe ZPS-ja vazhdojnë të jenë plotësisht të angazhuara në nivel diplomatik dhe nxisin aktivisht punësimin e punonjësve të kualifikuar të emëruar nëpërmjet shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuese për vendet e lira të shpallura. Në 2018, numri i personelit të emëruar përmes autoriteteve shtetërore ka lëvizur ndërmjet 11 dhe 13 punonjës, dhe më 31 dhjetor 2018 ishin gjithsej 13 punonjës të emëruar nga gjashtë shtete të ndryshme anëtare të BE-së (Bullgaria, Gjermania, Hungaria, Irlanda, Malta dhe Britania e Madhe) dhe dy shtete të treta kontribuese (Zvicra dhe SHBA-ja). Kjo pasqyron një rritje jo vetëm në numrin e punonjësve të emëruar nëpërmjet shteteve, por edhe në numrin e shteteve që kanë emëruar punonjës në këtë mënyrë.

Gjatë vitit 2018, NJBNI-ja, në bashkërendim me KA-në, përgatiti dhe përdori një formular të ri aplikimi si dhe vuri në zbatim udhëzime të reja administrative për të drejtën e kujdesit për fëmijët, mundësitë për punë me orar jo të plotë dhe certifikimin e personelit nga pikëpamja e sigurisë, për një proces më të thelluar verifikimi të sigurisë të personelit të ardhshëm.

Për një administrim më të mirë të personelit dhe forcimin e shërbimeve të saj, NJBNI-ja ka organizuar gjithashtu seanca trajnimi për punonjësit për tema në lidhje me burimet

Numri i personelit të DHSK-së dhe ZPS-së sipas shteteve




njerëzore, kryesisht me administrimin dhe drejtimin, organizimin e kohës dhe mësimin e gjuhëve përkatëse, për të zhvilluar dhe ndërtuar më tej aftësitë individuale të punonjësve.

Në mbështetje të një force punonjëse dinamike dhe për të krijuar një mjedis pozitiv pune, gjatë gjithë vitit 2018 punonjësit kishin në dispozicion shërbime këshillimi me informacione për aftësitë e përshtatjes dhe përballimit të situatave dhe për menaxhimin e stresit.


Në janar 2018, u mbajtën zgjedhjet e para për Organin përfaqësues të punonjësve të DHSK-së dhe ZPS-së (OPP) që çoi në krijimin e OPP-së. Gjatë gjithë vitit, NJBNI-ja dhe drejtuesit e lartë të të dy institucioneve u takuan disa herë me OPP-në për të diskutuar një sërë temash në një atmosferë respekti dhe bashkëpunimi të ndërsjellë.

Numri i gjithsejtë i personelit të DHSK-së dhe ZPS-së



Përbërja gjinore e personelit në DHSK dhe ZPS

FEMRA 38%
MESHKUJ 62%



6.2 Njësia e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit (NJSHTI)

Njësia e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit (NJSHTI) ofron një teknologji informative të sigurt (TI) dhe shërbime audiovizuale në mbështetje të punës së DHSK-së. Njësia ka përparuar më tej zhvillimin e infrastrukturës së TI-së dhe sistemeve të programeve kompjuterike, për të qenë në hap me rritjen në vijimësi të DHSK-së dhe forcimin e kornizës normative të saj.

Në 2018, u prezantua faqja e re e internetit e DHSK-së dhe ZPS-së për të mundësuar një ofrim më të strukturuar të informacionit si dhe në përgatitje për shtimin e procedurave gjyqësore dhe të veprimtarive të komunikimit dhe ndërgjegjësimit. Ndër objektivat madhore të arritura gjatë vitit ishte përfundimi i arkivit elektronik të dokumentacionit gjyqësor publik në bashkërendim me Njësinë për Informimin dhe Komunikimin me Publikun dhe Njësinë e Administrimit të Gjykatës.

NJSHTI-ja ka prokuruar dhe konfiguruar infrastrukturën e ardhshme të TI-së për mjediset e reja të DHSK-së dhe ZPS-së dhe po punon me shtetin pritës për konfigurimin e kapaciteteve audiovizuale të sallës së gjyqit të DHSK-së, për të siguruar që teknologjia e përdorur të mund të mbështetë veprimtarinë gjyqësore të parashikuar përmes seancave dëgjimore transparente por gjithsesi të sigurt.

NJSHTI-ja tani po kalon nga faza e ndërtimit në atë të funksionimit në vijimësi, duke u përqendruar në proceset e vënies në zbatim të TI-së së nevojshme për mbështetjen aktive të veprimtarive gjyqësore në të ardhmen. Gjithashtu, është siguruar ofrimi i audio-komunikimeve të mbrojtura, sipas kërkesës.

NJSHTI përuroi faqen e re të internetit të DHSK-së dhe ZPS-së dhe po kalon nga faza e ndërtimit në fazën e funksionimit, duke e vënë fokusin në proceset e vënies në zbatim të TI-së së nevojshme për mbështetjen e veprimtarive gjyqësore në të ardhmen.

6.3 Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme (NJAOSHP)

Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme (NJAOSHP) është përgjegjëse për pasuritë e paluajtshme të DHSK-së në shtetin pritës, duke përfshirë mirëmbajtjen e ndërtesave. Njësia është gjithashtu përgjegjëse për caktimin e zyrave brenda mjedisve, për shërbimet postare dhe të dërgesave, transportin, udhëtimet dhe logjistikën, dhe bashkëpunon ngushtësisht sidomos me Protokollin dhe Njësinë e Sigurisë.

Në 2018, NJAOSHP-ja vazhdoi bashkëpunimin me shtetin pritës rreth përgatitjeve për dorëzimin e mjedisve të reja të DHSK-së dhe ZPS-së, duke mirëmbajtur ndërkohë mjediset e punës për punonjësit në vendndodhjen aktuale. Njësia vazhdon të bashkërendojë punën në të gjithë DHSK-në dhe ZPS-në për të siguruar që shteti pritës t'i plotësojë të gjitha specifikimet funksionale të mjedisve të reja.

Objektivi parësor i NJAOSHP-së është të sigurojë dhe mirëmbajë një ambient të përshtatshëm pune, që u përgjigjet nevojave dhe kërkesave operative të të gjithë punonjësve dhe kontraktuesve të jashtëm, dhe të realizojë kalimin e DHSK-së dhe ZPS-së nga mjediset aktuale në mjediset e reja.

6.4 Njësia e Sigurisë (NJS)

Njësia e Sigurisë (NJS) kryen një gamë të shumëllojtë shërbimesh në mbështetje të DHSK-së dhe nxit një ndërgjegjësim me spektër të gjerë për rreziqet në nivel individual dhe organizativ.

Gjatë 2018, NJS-ja vazhdoi konsolidimin e marrëdhënieve efektive të punës me bashkëbiseduesit e vet në aparatit e sigurisë të shtetit pritës, për të siguruar monitorimin efektiv të rreziqeve. Mbështetja e ofruar prej institucioneve ligjzbatuese të shteteve anëtare

të BE-së dhe shteteve të treta kontribuuese përmes trajnimeve të specializuara ka kontribuar në krijimin e kapaciteteve të brendshme të rëndësishme të drejtpërdrejta për funksionimin e institucionit. Objektivi parësor i Njesisë vazhdon të jetë sigurimi i një programi efektiv të sigurisë për të minimizuar rrezikun ndaj personelit, operacioneve, reputacionit dhe bazës materiale. Kjo frymë e ka udhëhequr punën e NJS-së në përgatitjet për funksionalizimin e mjedisve të reja.

NJS-ja ka zbatuar një kornizë të menaxhimit të rreziqeve në udhëtime, për të siguruar mbështetje të vazhdueshme gjatë udhëtimeve për arsye pune, si dhe për të pakësuar ekspozimin e organizatës dhe të individëve ndaj rreziqeve. Ofrimi i mbështetjes dhe informacionit të përditësuar, të saktë dhe të lidhur me sigurinë gjatë udhëtimeve është thelbësor për garantimin e operacioneve efektive përtej kufijve të shtetit pritës.

6.5 Njësia e Financave dhe Buxhetit (NJFB)

Njësia e Financave dhe Buxhetit (NJFB) mbështet Administratoren në administrimin financiar dhe zbatimin e Marrëveshjes për subvencionim në përputhje me rregullat dhe rregulloret financiare të BE-së dhe atyre të brendshme. Nën drejtimin e Administratores, Njësia përgjigjet për bashkërendimin e planifikimit dhe përgatitjes së buxhetit vjetor. Kjo Njësi është përgjegjëse edhe për kryerjen e pagesave dhe evidentimin e shpenzimeve, forcimin e kontrolleve të brendshme financiare dhe ofrimin e ndihmës dhe të trajnimeve në vendin e punës.

Me vendim të Këshillit (CFSP) 2018/856, shtetet anëtare të BE-së kanë miratuar një buxhet prej 86.250.000 eurosh për periudhën nga 15 qershori 2018 deri në 14 qershor 2020.

Përveç fondeve të akorduara nga BE-ja, DHSK-ja vazhdon të menaxhojë edhe fondet

e marra nga qeveria norvegjeze, në shumën prej 80 milionë koronash norvegjeze, për të mbështetur zhvendosjen e procedurave në mjediset e reja në shtetin pritës, dhe nga qeveria zvicerane, në shumën prej 181.200 eurosh për veprimtaritë e DHSK-së për komunikim dhe ndërgjegjësim në Kosovë gjatë 2018 dhe 2019.

NJFB-ja vazhdon të mbështetë një administratë efikase dhe të pavarur përmes ngritjes së një sërë sistemesh, rregullash dhe procedurash që sigurojnë miradministrimin financiar të fondeve. Në përputhje me Marrëveshjen për subvencionim, në vitin 2018 u bë verifikimi i pavarur i shpenzimeve të llogarive financiare nga një firmë e jashtme auditimi, e cila nuk bëri asnjë konstatim faktik. Në fund të çdo periudhe buxhetore, llogaritë e mbyllura dhe raportet e verifikimit të shpenzimeve i dërgohen Shërbimit të Instrumentit të Politikës së Jashtme (IPJ) të Komisionit Evropian.

NJFB-ja ndihmon Administratoren për të garantuar përdorimin e duhur dhe miradministrimin financiar të fondeve akorduar DHSK-së. Llogaritë financiare i nënshtrohen rregullisht verifikimeve të shpenzimeve nga një firmë e jashtme auditimi. Që prej krijimit të DHSK-së, verifikimet e shpenzimeve nuk kanë konstatuar asnjë shkelje.

6.6 Njësia e Prokurimit (NJP)

Njësia e Prokurimit (NJP) është përgjegjëse për të gjitha blerjet dhe kontraktimet e furnizimeve, shërbimeve dhe punimeve. Kontratat jepen mbi bazën e parimeve të transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit. Përveç menaxhimit të prokurimeve për nevojat e funksionimit të DHSK-së, Njësia siguron që DHSK-ja t'u përmbahet rregullave të BE-së (EU PRAG)

në veprimet e saj prokuroese. Përveç rolit të saj prokuroes, NJP-ja gjithashtu mbështet DHSK-në në menaxhimin dhe monitorimin e kontratave, si edhe me ofrimin e trajnimeve të rregullta për personelin e brendshëm dhe mbajtësit e buxhetit në lidhje me procesin e prokurimit dhe përgjegjësitë për menaxhimin e kontratave.

Në 2018, janë iniciuar 139 procedura të reja prokurimi dhe modifikimi të kontratave, dhe janë lidhur 92 kontrata të reja shërbimi dhe furnizimi, me vlerë nga 2.500 deri në 2,4 milion euro.

**ZYRA E
PROKURORIT TË
SPECIALIZUAR**

PARATHËNIE

Në muajt e fundit të 2018, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) e ka rritur ndjeshëm shkallën dhe intensitetin e veprimtarive të saj. Janë intervistuar më shumë dëshmitarë, janë ndjekur më shumë pista hetimi dhe janë mbledhur dhe shqyrtuar më shumë prova për të çuar përpara hetimet. Në të njëjtën kohë, në Kosovë, në rajon dhe në komunitetin ndërkombëtar janë rritur pritshmëritë për sa u takon hetimeve. Fokusi ynë është që t'i përmbushim këto pritshmëri dhe unë besoj se kemi ndërmarrë hapat e nevojshëm për ta bërë këtë realitet. Viti i ardhshëm do të jetë vit kyç.

Si Prokuror i Specializuar, u jam mirënjohës paraardhësit tim, David Shvendiman, si edhe zëvendësit tim, Kwai Hong Ip, për përpjekjet që kanë bërë gjatë shumë viteve për ta bërë ZPS-në institucionin që është sot dhe për t'i sjellë hetimet deri në pikën në të cilën i mora unë në shtator të 2018. Gjithashtu i jam mirënjohës zemërgjerësisë largpamëse së shteteve anëtare të BE-së dhe vendeve kontribuuese, të cilat kanë financuar punën e ZPS-së dhe përpara saj, të Task Forcës Hetimore Speciale, dhe që kanë siguruar burimet dhe mbështetjen që meritojnë pretendimet të cilat ne po hetojmë.

Në krijimin e ZPS-së nga themeli, paraardhësi dhe zëvendësi im kanë shpenzuar kohë dhe përpjekje për rekrutimin e hetuesve, prokurorëve, këshilltarëve ligjorë, specialistëve për mbrojtjen e dëshmitarëve, punonjësve të sigurisë dhe personelit mbështetës më të kualifikuar dhe më të përshtatshëm. ZPS-ja ka një personel të vogël, po të kemi parasysh shkallën e hetimeve dhe sfidat me të cilat përballemi, por një personel tepër të kualifikuar, jashtëzakonisht të aftë dhe, mbi të gjitha, tejet të motivuar për ta përfunduar detyrën sa më shpejt që të jetë e mundur.

Takimi im i parë pas mbërritjes në ZPS në shtator 2018 ishte me punonjësit që merreshin me mbrojtjen e dëshmitarëve. Kjo ishte e qëllimshme. Frikësimi i dëshmitarëve ka minuar procedime të mëparshme të rëndësishme të lidhura me Kosovën dhe mbetet një problem serioz. Suksesi apo dështimi i hetimeve që unë kryesoj varet nga gatishmëria e dëshmitarëve për të dëshmuar. Nëse dëshmitarët do të jenë të gatshëm të hyjnë në sallën e gjyqit dhe të rrëfejnë me saktësi dhe besnikëri atë që kanë përjetuar, jam i bindur se do të mund të vendosim drejtësi me këtë punë që kemi marrë përsipër.

Hetuesit dhe ekspertët që punojnë me dëshmitarët kanë përvojë të madhe dhe janë përpjekur të nxjerrin mësim nga procedimet e mëparshme, jo vetëm për sa i përket mënyrës se si i mbrojmë dëshmitarët, por edhe se si të komunikojmë me ta për atë çka mund të bëjmë ne për të garantuar sigurinë e tyre dhe të familjeve të tyre.

Kohët e fundit, dukshmëria e ZPS-së në Kosovë është rritur, në veçanti që kur ne filluam t'u dërgonim fletëthirrje ish-pjesëtarëve të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Me përparimin e hetimeve, dukshmëria jonë do të rritet në mënyrë të pashmangshme. Vendimet nëse do të ngrihen akuza, kur do të ngrihen akuza, dhe për çfarë do të ngrihen akuza, do të merren me kujdesin më të madh dhe pas përfundimit të një procesi rrënjësor, bazuar vetëm në ligj dhe në fakte.

Mbetemi të angazhuar për të arritur rezultate që pranohen si legjitime nga komunitetet e prekura në Kosovë, më gjerësisht në rajon, dhe në komunitetin ndërkombëtar, dhe për t'i vënë përpara përgjegjësisë personat që kanë kryer veprime që përfshihen në mandatin tonë.

Xhek Smith
Prokurori i Specializuar
Dhjetor 2018

ZHVILLIMI I ZYRËS SË PROKURORIT TË SPECIALIZUAR

Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) u krijua në Hagë më 1 shtator 2016, si një institucion i ndërkombëtarizuar, i zhvendosur i Kosovës.

Gjatë vitit 2018, nën udhëheqjen e David Shvendimanit, Prokurori i parë i Specializuar, dhe të Xhek Smithit, pasardhësit të tij, ZPS-ja i ka çuar më tej hetimet e pretendimeve që përmban Raporti i Këshillit të Evropës me titull **Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë**.

Në muajt e fundit, ZPS-ja e ka përsheptuar ritmin e hetimeve. Si rrjedhojë, janë kryer më shumë intervista, ndër të cilat edhe me ish-pjesëtarë të rangut të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe janë mbledhur e analizuar më shumë prova.

Një tregues i ritmit të përsheptuar të hetimeve është lëshimi i fletëthirrjeve, çka ka kontribuar edhe në rritjen e dukshmërisë së ZPS-së, si në Kosovë, po ashtu edhe më gjerë në rajon.

Mandati i ZPS-së buron nga Amendamenti nr. 24 i Kushtetutës së Kosovës dhe Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, miratuar nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2015, në bazë të të cilëve u krijuan ZPS-ja dhe Dhomat e Specializuara të Kosovës. Ky legjislacion i jep ZPS-së autoritetin për të hetuar dhe ndjekur penalisht krime të kryera në lidhje me veprime të identifikuar në Raportin e Këshillit të Evropës.

ZPS-ja është duke hetuar krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare, që do të thotë, kryesisht krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, sikurse përcaktohen në të drejtën

zakonore ndërkombëtare dhe në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Krimet që përfshihen në juridiksionin e ZPS-së janë krime të kryera apo të nisura në Kosovë, apo të kryera nga ose kundër personave me shtetësi kosovare/të ish-RFJ-së, në periudhën trevjeçare nga 1 janari 1998 deri më 31 dhjetor 2000.

Personeli – i cili përfshin prokurorë, hetues, analistë, profesionistë të sigurisë, specialistë të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe personel mbështetës – janë që të gjithë ndërkombëtarë. Në fund të vitit 2018, ishin plotësuar 63 nga 76 poste.

ZPS-ja ka kompetencë, ndër të tjera, të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të të dyshuarve, viktimave dhe dëshmitarëve, të mbledhë dhe të këqyrë të dhëna dhe prova, dhe të marrë vendime në lidhje me fillimin dhe vazhdimin, ose përfundimin e procedurave penale. Ajo kërkon të nxjerrë përpara përgjegjësisë individë për krimet që përfshihen në mandatin e saj.

Ndihma nga autoritetet e vendeve të Bashkimit Evropian dhe komuniteti më i gjerë ndërkombëtar është thelbësore për hetimet. ZPS-ja ka kërkuar dhe vazhdon të kërkojë ndihmë nga autoritete dhe institucione të tilla vendore apo ndërkombëtare, për të çuar përpara hetimet dhe për të siguruar që ato të kryhen në mënyrë objektive, profesionale, të paanshme, të plotë dhe mirë.

David Shvendiman, ish-prokuror federal i SHBA-së dhe më herët zëvendësprokuror dhe shefi i Departamentit special për krime lufte në Bosnjë dhe Hercegovinë, u largua nga detyra

e Prokurorit të Specializuar në fund të marsit 2018. Më 11 shtator 2018, pas një procesi të pavarur përzgjedhës të drejtuar nga Bashkimi Evropian, në atë detyrë erdhi Xhek Smith, një prokuror amerikan me përvojë si në hetime politike të nivelit të lartë, ashtu edhe në hetime penale ndërkombëtare.


Në periudhën midis largimit të z. Shvendiman dhe mbërritjes së z. Smith, hetimet e ZPS-së u drejtuan nga Kwai Hong Ip, zëvendësi i Prokurorit të Specializuar.

Zoti Smith vizitoi Kosovën në tetor dhe nëntor 2018 për një sërë takimesh me zyrtarë ndërkombëtarë dhe të Kosovës, përfshirë ministrin e drejtësisë së Kosovës, Abelard Tahiri, dhe zyrtarë të lartë të Ministrisë së Drejtësisë.

Gjatë vitit të kaluar, ZPS-ja ka këqyrur me kujdes provat e mbledhura që nga fillimi i hetimeve të saj, për të vlerësuar vlerën dhe përshtatshmërinë e tyre, si edhe për të siguruar pranueshmërinë e tyre nga gjykata.

Numri i personelit

Me shtimin e 11 vendeve të reja të punës, numri i personelit të ZPS-së u rrit gjatë vitit 2018, duke e çuar numrin e përgjithshëm në 76. Në fund të vitit ishin plotësuar 63 nga 76 vendet e caktuara të punës, që përfaqësojnë 83 për qind të personelit dhe 22 shtetësi, përfshirë pesë persona të emëruar nga shtetet. Ndërkohë, ka vazhduar procesi i rekrutimit për 13 vendet e mbetura.



Prokurori i Specializuar



Prokurori i Specializuar Xhek Smith dhe Administratorja Fidelma Donlon – shtator 2018

Xhek Smith, prokuror amerikan me përvojë si në hetime politike të nivelit të lartë ashtu edhe në hetime penale ndërkombëtare, mori detyrën e Prokurorit të Specializuar më 11 shtator 2018.

Në përputhje me nenin 36 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, z. Smith nënshkroi deklaratën solemne se do t'i kryejë funksionet e tij në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe të ndërgjegjshme. Ai u përzgjodh në postin e Prokurorit të Specializuar në maj 2018, pas një procesi të drejtuar nga Bashkimi Evropian dhe u emërua nga shefja e misionit të EULEX-it, Aleksandra Papadopulu.

Përpara emërimit të tij si Prokuror i Specializuar, zoti Smith ishte zëvendëskryetar dhe

shef i seksionit të padive në Korporatën Spitalore të SHBA, organizata më e madhe joshtetërore e shërbimit shëndetësor në Shtetet e Bashkuara, post të cilin e mbante që nga shtatori i 2017.

Në periudhën shkurt 2015 deri në gusht 2017, zoti Smith ishte ndihmësprokuror i parë federal dhe ushtrues i detyrës së prokurorit federal në distriktin e mesëm të shtetit Tenësi (Tennessee).

Në periudhën nga 2010 deri në 2015, zoti Smith ka shërbyer si shef i Seksionit të Integritetit Publik të Departamentit të Drejtësisë së SHBA-së, ku ishte i ngarkuar me mbikëqyrjen e procedimit të çështjeve të ndërlikuara të korrupsionit publik në gjithë Shtetet e Bashkuara.

Nga 2008 në 2010, zoti Smith ka punuar si koordinator i hetimeve në Zyrën e Prokurorit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare (GJPN). Në atë cilësi ai ka mbikëqyrur hetime të ndjeshme të zyrtarëve qeveritarë dhe forcave militare të huaja për krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe për gjenocid.

Zoti Smith erdhi në GJPN nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm të Distriktit Lindor të Nju Jorkut, ku shërbeu për nëntë vite në një numër postesh, përfshirë si shef i padive penale dhe zëvendës shef i Seksionit penal. Si shef i padive penale, z. Smith kishte nën vartësi rreth 100 prokurorë penalë në një gamë fushash, ndër të cilat korrupsioni publik, terrorizmi, krimi i dhunshëm dhe bandat, si edhe krimi ekonomik dhe mashtrimet financiare komplekse.

Përpara se të bëhej ndihmësprokuror federal, zoti Smith punoi për pesë vite si ndihmësprokuror i Distriktit në zyrën e Prokurorit të Distriktit të Kontesë së Nju Jorkut, ku punoi në njësitë e krimeve seksuale dhe të dhunës në familje.

Zoti Smith ka marrë një numër çmimesh gjatë karrierës së tij, si Çmimin e Drejtorit të Departamentit të Drejtësisë të SHBA-së, Çmimin e Prokurorit të Përgjithshëm të

Shteteve të Bashkuara për Shërbime të Shquara; Çmimin e Shoqatës Federale të Juristëve për Prokurorët e Rinj Federalë; Çmimin Charles Rose të Shoqatës së Distriktit Lindor; medaljen Henry L. Stimson të Shoqatës së Juristëve të Kontesë së Nju Jorkut; dhe bursën Wasserstein të Fakultetit të Drejtësisë së Harvardit.

Ai është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë të Harvardit dhe Universitetin Shtetëror të Nju Jorkut në Oneonta.



Vizita në Kosovë

Prokurori i Specializuar Xhek Smith vizitoi Kosovën në tetor dhe nëntor 2018 për një sërë takimesh me zyrtarë ndërkombëtarë dhe nga Kosova.

Gjatë vizitës, ai u takua, ndër të tjerë, me drejtues të organizatave ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve anëtare të BE-së dhe me ministrin e drejtësisë së Kosovës Abelard Tahiri, si edhe me zyrtarë të lartë të Ministrisë së Drejtësisë.



Prokurori i Specializuar Xhek Smith duke folur përpara diplomatëve nga Shtete Anëtare të BE-së dhe Shtetet e Treta Kontribuese në selinë e EULEX-it në Prishtinë

Prokurori i Specializuar po punon për marrjen e një vendimi për ndjekje penale dhe do të ngrejë akuza vetëm kur të jetë i bindur se: provat janë të pranueshme nga Dhomat e Specializuara; provat do të jenë të disponueshme për t'u paraqitur në gjyq kur të vijë koha; provat do të jenë të mjaftueshme për të vërtetuar përtej

dyshimit të arsyeshëm çdo element të çdo veprë penale për çdo person të akuzuar; gjasat janë që çështja gjyqësore do t'i bëjë ballë një mbrojtjeje të informuar si duhet, inteligjente dhe të fortë; dhe se çështja gjyqësore do të përfundojë me vendime fajësie të cilat do të konfirmohen në apel.

Vendimi i Prokurorisë



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Në përputhje me nenin 38(4) të Ligjit dhe sipas rregullës 86 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në korrik 2017, Prokurori i Specializuar, përpara se të ngrihet një aktakuzë, duhet të bindet se "ekziston dyshim i bazuar mirë se një i dyshuar ka kryer, ose ka marrë pjesë në kryerjen e një vepre penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara".

ZPS-ja kërkon të arrijë rezultate që janë legjitime dhe perceptohen si legjitime nga ata që preken prej tyre, në Kosovë, në rajon dhe në botën më të gjerë. Vetëm kështu mund

të hiqet njolla e ngjarjeve të trajtuara në Raportin e Këshillit të Evropës si pengesë për integrimin e plotë të Kosovës në komunitetin ndërkombëtar.

DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS – RAPORT 2018

Botuar dhe shpërndarë nga: Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK)
Botuar në tri gjuhë: anglishte, shqipe, serbishte

Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit të DHSK-së: www.scp-ks.org
Për pyetje nga media në lidhje me Dhomat e Specializuara të Kosovës: mediaKSC@scp-ks.org
Për pyetje nga media në lidhje me Zyrën e Prokurorit të Specializuar:
spokespersonSPO@scp-ks.org

Paraqitja grafike: CITYO GRAPHYS



WWW.SCP-KS.ORG